

Vildan
Drpljanin

Natasha
Petkovska

sfidimi i statukuosë së
sindikalizmit bashkëkohor maqedonas

ALEANCË

SOLIDARITET

DHE BETEJË

СОЈУЗНИШТВО СОЛИДАРНОСТ И БОРБА

ОСПОРУВАЊЕ НА СТАТУС-КВОТО ВО
МАКЕДОНСКИОТ СОВРЕМЕН СИНДИКАЛИЗАМ

ALEANCË SOLIDARITET DHE BETEJË



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT

SFIDIMI I STATUKUOSË SË
SINDIKALIZMIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS

AUTORË:

VILDAN DRPLJANIN
NATASHA PETKOVSKA

ПРЕВОД/ПËРКТИМИ:

SHENASI JAJI

SHKUP, VITI 2021

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
përfaqësuar nga kryetarja Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktimi:

Uraniya Pirovska, drejtoreshë ekzekutive e Komitetit të Helsinkit
për të Drejtat e Njeriut

Autorë:

Vildan Drplanin
Natasha Petkovska

Redaktimi gjuhësor:

Jetmir Ziba

NUMRI CIP

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

331.105.44:347.19(497.7)(047.31)

DRPLJANIN, Vildan

Aleancë, solidaritet dhe betejë [Електронски извор] : sfida i statukuosë së
sindikalizmit bashkëkohor maqedonas / Vildan Drpljanin, Natasha Petkovska ; [përk-
thimi Shenasi Jaji]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://mhc.org.mk/>. - Превод на делото:

Сојузништво, солидарност и борба : оспорување на статус-квото во македонскиот
современ синдикализам. - Текст во PDF формат, содржи 54 стр. - Наслов преземен од
екранот. - Опис на изворот на ден 25.06.2021.

- Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 49-54

ISBN 978-608-4790-94-5

1. Petkovska, Natasha [автор]

а) Синдикати -- Правен субјективитет -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 54212357

SHËNIME TË VEÇANTA

Pyetja kryesore që u shtjellua në të gjithë procesin e hartimit dhe e cila kërkon një përgjigje nga ky punim është: “Si mundet që subjektiviteti ligjor i sindikatave të kontribuojë në transformimin e lëvizjes sindikale, me qëllimin përfundimtar - përmirësimin e të drejtave të punëtorëve/njeriut?”. Punimi synon të ofrojë rekomandime dhe opsione për politika publike në fushën e bashkimit të sindikatave dhe të drejtave të punëtorëve.

Në fillim dëshirojmë të shprehim falënderimet tona të veçanta për Tome Georgievski - pensionist dhe ish nënkryetar i Federatës së Sindikatave të Maqedonisë, Xhejlan Veliu - punëtorë e magjistruar në të drejtën penale dhe Petar Dimitrov - punëtor i magjistruar në të drejtën afariste në temën - subjektiviteti juridik i shoqërive tregtare, për recensën nga këndvësjetime të ndryshme të versionit të parë të këtij punimi. Falënderime të veçanta shprehim edhe për Biljana Çklamovska - bashkëpunëtorë e jashtme e Unionit të Sindikatave Autonome dhe të Pavarura të Maqedonisë, Zoran Vasileski - avokat, Ina Xhugumanova - këshilltare juridike dhe aktiviste për të drejtat e njeriut, Mariglen Demiri - studiues, Marjan Risteski - kryetar i Konfederatës së Organizatave Sindikale të Maqedonisë dhe Neda Petkovska - studiuese në fushën e barazisë gjinore, për recensën e versionit përfundimtar të këtij punimi.


Falënderim të veçantë shprehim edhe ndaj Institutit për Politikë Evropiane (EPI) për mbështetjen në zbatimin e hulumtimit themeltar „BASHKIM, KONFUZION APO KEQPËRDORIM: Roli i sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve “.

Gjetjet e hulumtimit nuk do të ishin të plota po të mos ishte bashkëpunimi me Sindikatën e Pavarur për Arsim dhe Shkencë (SPASH), sindikatën e KB Pellagonija SH.A. Manastir, sindikatën e ERIDEN DOOEL - Manastir, Agro-sindikatën, Sindikatën e Postës së Maqedonisë Shkup - Dega e Kumanovë, Sindikatën e punëtorëve nga industria e tekstilit, lëkurës dhe këpucëve (STLK), Sindikatën e Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SPASHK), Sindikatën e Pavarur të Punëtorëve të Energjetikës dhe Ekonomisë (SPPEE), Sindikatën e Pavarur Akademike (SPA), Sindikatën e Kulturës (SKRM), Sindikatën e Operatorëve Postarë dhe Telekomunikacionit (SOPT), Sindikatën e Pavarur të Mbrojtjes (SPM), Sindikatën e Punëtorëve të Pyllltarisë, Industrisë së Drurit dhe Energjisë (SPPIDE), Sindikatën e Pavarur të Shëndetësisë, Farmacisë dhe Mbrojtjes Sociale (SPSHFMS) dhe Konfederatën e Sindikatave të Lira (KSL).

ABSTRAKT

Ky punim analizon rolin e sindikatave në marrëdhëniet e punës përmes prizmit të subjektivitetit të tyre juridik. Qëllimi është, duke paraqitur dy pikëpamje të ndryshme mbi statusin juridik, për të treguar se si gjetjet e hulumtimit të kryer imponojnë tendencën për të sfiduar statukuonë ekzistuese. Duke pasur parasysh fuqinë asimetrike midis sindikatave të nivelit më të lartë dhe sindikatave “të ulëta” në ligjërimitin për subjektivitetin e tyre juridik, punimi tregon se kur të gjitha sindikatat të kenë cilësinë e një personi juridik, atëherë forcohet në thelb organizimi sindikal, në krahasim me statusin aktual juridik. Argumenti tregon se përvetësimi i statusit të një personi juridik me momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës, për sindikatat paraqet hapin e parë në rrugën e gjatë drejt forcimit të aleancës, solidaritetit dhe betejës për të realizuar interesat dhe qëllimet e përbashkëta. Duke u nisur nga përgjigjet rreth funksionit themelor të sindikatës dhe statusit juridik të të gjitha sindikatave, ky punim kontribuon në krijimin e politikave publike për të forcuar rolin e sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Fjalët kyçe: sindikatë, subjektivitet juridik, sindikatë e nivelit më të ulët, sindikatë e nivelit më të lartë, të drejtat e punëtorëve, Ligji për Marrëdhëniet e Punës.



- PËRMBAJTJA -

7	LISTA E SHKURTESAVE
8	HYRJE
14	QASJA METODOLOGJIKE DHE KËRKIMORE
17	DREJT STATUKUOSË SË SINDIKALIZMIT
17	Evolucioni i sindikatave në Maqedoni
20	Vlerësim krahasues në kontekstin maqedonas
22	Struktura juridike e sindikatave sot
24	PJESA E PARË - SUBJEKTIVITET JURIDIK VETËM PËR SINDIKATËN E NIVELIT MË TË LARTË
26	1.1.Mundësitë e organizimit sindikal dhe lufta për të drejtat e punëtorëve
27	1.2.Debat teorik - implikime thelbësore
29	1.3.Rreziku nga monopolizimi i organizimit sindikal
32	2.PJESA E DYTË - SUBJEKTIVITET JURIDIK PËR TË GJITHA SINDIKATAT
34	2.1.(Pa)mundësia për ushtrimin e funksionit themelor të sindikatave
36	2.2.Subjektiviteti juridik si bazë për funksionimin e sindikatave..
40	2.3.Motivi për t'u bashkuar
44	VËZHGIME PËRFUNDIMTARE
47	LISTA E REKOMANDIMEVE TË SYNUARA
49	LITERATURA E KONSULTUAR
51	DOKUMENTE
53	LEGJISLACIONI

-LISTA E SHKURTESAVE-

LMP	Ligji për Marrëdhëniet e Punës
KOSM	Konfederata e Organizatave Sindikale në Maqedoni
KSL	Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
SPA	Sindikata e Pavarur Akademike
SPASH	Sindikata e Pavarur për Arsim dhe Shkencë
SKRM	Sindikata e Kulturës e Republikës së Maqedonisë
SPASHK	Sindikata e Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
SOPT	Sindikata e Operatorëve Postar dhe Telekomunikacionit
SPPEEM	Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Energjisë dhe Ekonomisë së Maqedonisë
SPSHFMS	Sindikata e Pavarur për Shëndetësi, Farmaci dhe Mbrojtje Sociale e Maqedonisë
LSM	Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë
SPITLK	Sindikata e Punëtorëve të Industrisë së Tekstilit, Lëkurës dhe Këpucëve
BSAPM	Bashkimi i Sindikatave Autonome dhe të Pavarura të Maqedonisë
UPOZ	Sindikata e Punëtorëve të Administratës, Organeve Gjyqësore dhe Shoqatave të Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë

HYRJE

„Të mundohesh edhe të përpiqesh dhe prapë të jesh i unshëm, i ngratë. Puntor i përvujtun: të mos kesh asgja, të vëjsh për gjithçka e ti e vllaznit tuej të bani çdo gja! Pallate të ndërtosh nëpër izbe të jetosh prej djepit deri në grop’ të jesh gjithnji rob. Nga mundi tuej të jetoj i huej! O vlla! Pështye këtë jetë! Me vllaznit tuej, me mundin tuej zhdukeni këtë botë dhe tjetër ndërtoni - vllaznisht!“

- Koço Racin (1936)¹

Punëtorët e lodhur maqedonas, për një pagë minimale shpesh punojnë me kohë të plotë çdo ditë të javës, nuk kanë të drejtë në pushim vjetor më të gjatë se 10 ditë dhe nuk paguhen për punën e kryer jashtë orarit.² Paga minimale neto në vend është aktualisht 15,194 denarë, që është një rritje prej vetëm 239 denarë në krahasim me vitin e kaluar,³ ndërsa paga mesatare neto është 27,948 denarë,⁴ por shumica e njerëzve jo vetëm që punojnë për një pagë shumë më të ulët se

mesatarja, por shpesh punojnë për një pagë më të ulët se paga e përcaktuar minimale.⁵ Për të pasur një pasqyrë të qartë të situatës me punëtorët dhe gratë punëtore në Maqedoni, e gjithë kjo duhet të vendoset në kontekstin e shpërndarjes së pabarabartë të pasurisë, dhe për të kuptuar situatën e punëtorëve të shtypur, është e rëndësishme të shihet se në çfarë rrethanash është gjetur lëvizja sindikale dhe deri në çfarë mase sindikatat ushtrojnë rolin

1 Kosta Solev Racin, *Vepra poetike* (Makedonska kniga 1936).

2 Vildan Drpljanin, „Puna dhe djersa janë tonat, paratë dhe kapitali u përkasin 900 njerëzve në vend“ (ResPublica, 2020) <<https://respublica.edu.mk/mk/blog/900>> qasja e fundit më 03.05.2021.

3 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Paga minimale po rritet, e diela do të jetë një ditë jo-pune, punëtorët në qendrat tregtare do të kenë një pagë të dyfishtë dhe një ditë pushim “ (31 mars 2021) <<https://vlada.mk/node/24758>> qasja e fundit më 04.05.2021.

4 Enti Shtetëror i Statistikës, „Paga mesatare mujore e paguar neto për punonjës, shkurt 2021“ (21 prill 2021) <<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbtxt=40>> qasja e fundit më 04.05.2021.

5 Vildan Drpljanin, „Puna dhe djersa janë tonat, paratë dhe kapitali u përkasin 900 njerëzve në vend“.

e tyre mbrojtës.

Një punëtor në Maqedoni me punën e tij prodhon mesatarisht rreth 1130 euro në muaj, nga të cilat rreth 400 euro mbeten për ta, afërsisht 140 euro janë të destinuara për taksa, dhe 590 euro të mbetura janë për bosët e punës - punëdhënësit e tyre.⁶ Nëse, nga ana tjetër, të ardhurat e të pasurve (1 përqind e të gjithë popullsisë) dhe të ardhurat e 99 përqindëve të mbetur thjesht do të paraqiteshin, shpërndarja e pasurisë në Maqedoni do të dukej si në vijim:

Nëse buxheti i shtetit

do të ishte, 100 denarë,

14 denarë u shpërndahen

9.000 personave dhe 86

denarë 891.000 njerëzve

Ky çekuilibër i fuqisë, që rezulton nga vlera e tepërt e prodhuar nga ana e punëtorit,⁷ është katalizatori kryesor i dallimeve klasore dhe krijimit të shoqërive ku një grup i vogël njerëzish posedojnë shumë më shumë pasuri krahasuar me të gjithë të tjerët. Kriza shëndetësore në rritje të shpejtë dhe pasojat e saj

si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga virusi KOVID-19,⁸ kanë prodhuar implikime të gjera ekonomike dhe sociale nga të cilat njerëzimi për shumë kohë nuk do të rimëkëmbet. Punëtorët dhe gratë punëtore ishin të parët që u goditën, duke i dhënë kësaj situatë në mënyrë të pashmangshme karakterin e një krize pune. Situata e krizës për punëtorët nënkuptonte një luftë për të ruajtur jetën e tyre dhe shëndetin e të dashurve të tyre, por gjithashtu një luftë për të shpëtuar mbijetesën e tyre.⁹

Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave, e matur nga indeksi Gini i të ardhurave neto mujore në vend, u rrit nga 30 në 33.5 përqind për periudhën shkurt - qershor 2020, e cila është një rritje shumë e lartë për një periudhë kaq të shkurtër.¹⁰ Kjo tregon se kriza nuk kishte ndikim të njëjtë ndaj grupeve shoqërore, në proporcion me fuqinë e tyre. Kështu, grupet më pak të fuqishme shoqërore u prekën ndjeshëm më shumë nga pasojat negative të krizës, sepse shpesh bëhet fjalë për njerëz me vende të pasigurta pune.¹¹ Një shembull i tillë janë gratë punëtore në industrinë e tekstilit, kontratat e punës të të cilëve shpesh lidhen për një periudhë prej vetëm një muaj. Një arsye tjetër për rritjen e pabarazisë në të ardhura është se vitin e kaluar të ardhurat e

6 Eurostat, Pasqyrë krahasuese, të dhënat më të fundit të disponueshme për Maqedoninë janë nga viti 2019, një pasqyrë përmbledhëse është e mundur dhe e disponueshme në lidhjen vijuese: <https://cutt.ly/zBR4dxR>.

7 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni*, (Lëvizja majtiste „Solidarnost“, 2017).

8 Sëmundja e shkaktuar nga koronavirusi i ri SARS-COV-2.

9 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport i veçantë për situatën e të drejtave të njeriut në kohën e Kovid-19“ (13 tetor 2020) <<https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshtha%0d1%98-za-sosto%0d1%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>>.

10 Biljana Jovanović, Branimir Jovanović, Viktor Mitevski, Viktor Stojkoski, „Pabarazia në kohën e koronavirusit - Efektet e pandemisë Kovid-19 në ekonominë maqedonase: *shkurtimisht për politikën*“ (2021) <<https://zmai.mk/wp-content/uploads/2021/01/Efektite-od-Kovid-vrz-MK-ekonomija-MK.pdf>>, faqe 18.

11 Ibid. Faqe 18.

punonjësve në aktivitetet që preken më shumë nga kriza u ulën ndjeshëm, në krahasim me të ardhurat nga kapitali të cilat paraqesin burimin kryesor të të ardhurave për më të pasurit.¹²

jnë punë intensive.¹⁵ Në muajt mars dhe prill 2020, menjëherë pas futjes




Figura 1 - Pasqyrë grafike e Indeksit Gini për periudhën shkurt - qershor 2020.¹³

Përfundimet nga hulumtimi mbi efektet e pandemisë ndaj grupeve më pak të fuqishme shoqërore tregojnë se më të prekur janë personat me të ardhura afër pagës minimale, të rinjtë dhe gratë, të ardhurat e të cilëve janë ulur ndjeshëm në krahasim me të ardhurat e qytetarëve të tjerë,¹⁴ kurse më fuqishëm janë goditur edhe rajonet më të varfra dhe industrinë që kërko-

në fuqi të masave të para për t'u përballur me krizën, u vërejt një rënie e dukshme e prodhimit industrial të tekstileve, veshjeve dhe lëkurës.¹⁶ Në vitin 2020, numri i përgjithshëm i të papunëve në qytetet ku industria e tekstilit është më e pranishme është rritur me 128 përqind në krahasim me vitin 2019.¹⁷ Kjo do të thotë që në vitin 2020 janë regjistruar 6783 per-

12 Ibid. Faqe 18.

13 Pasqyra grafike është marrë nga Biljana Jovanović, Branimir Jovanović, Viktor Mitevski, Viktor Stojkoski, „Pabarazia në kohën e koronavirusit - Efektet e pandemisë Kovid-19 në ekonominë maqedonase: *shkurtimisht për politikar*“ (2021).

14 Ibid. Faqe 20.

15 Ibid. Faqe 21.

16 Shoqata për hulumtim dhe analiza ZMAIS, „Efektet e KOVID-19 në prodhimin industrial të industrisë së tekstilit dhe lëkurës“ (29 mars 2021) <<https://zmai.mk/efektite-od-covid-19-vrz-industriskoto-proiz/>>.

17 Këto qytete janë Shtip, Tetovë, Shkup, Prilep dhe Kumanovë. Shih më shumë Shoqata për hulumtim dhe analiza ZMAIS, „Rritje

sona të rinj të papunë në industrinë e tekstilit, ndërsa në vitin 2019 ky numër ishte vetëm 2971.¹⁸

Gratë punëtore në industrinë e tekstilit janë shembulli më i përshatshëm për të analizuar efektet e krizës mbi punëtorët në Maqedoni. Kur kësaj kategorie punëtorësh i qasemi nga aspekti ndërsektorial, vërehet se në këtë kategori përfaqëson të gjitha grupet më pak të fuqishme shoqërore - të rinjtë, gratë, njerëzit nga rajone më të varfra dhe industritë me punë intensive. Në pesë vitet e fundit, arsyeja më e zakonshme për ndërprejen e marrëdhënies së punës në industrinë e tekstilit është skadimi i kohës së specifikuar për të cilën është lidhur kontrata e punës, kurse numri i punëtorëve që kanë humbur punën në vitin 2020 mbi këtë bazë ka shënuar një rritje me 123 përqind.¹⁹ Ajo që e përkeqëson situatën është se humbja e vendit të punës nuk është i vetmi problem me të cilin përballen gratë punëtore në industrinë e tekstilit. Gratë punëtore në industrinë e tekstilit janë midis 17,000 punëtorëve që

nuk morën pagat e tyre të merituar për tre muaj për shkak të bllokadës së miratimit të masave ekonomike në Kuvend nga ana e opozitës.²⁰ Në muajin prill 2021, 6,000 gratë punëtore në industrinë e tekstilit u dërguan në ‘pushim të detyruar’, ndërsa punëdhënësit prisnin për ndihmën financiare të shtetit, duke marrë pagat nën pagën e përcaktuar minimale për këtë periudhë.²¹

Sipas të dhënave më të fundit të disponueshme, në Maqedoni në vitet e fundit rreth 450,000 njerëz jetonin nën kufirin relativ të varfërisë, ndërsa përqindja e njerëzve që jetonin nën vijën e varfërisë absolute ishte rreth 4.6,²² ose afërsisht 100,000 njerëz.²³

Duke pasur parasysh të dhënat nga Agjencia e Punësimit për 43,086 persona që kishin mbetur të papunë pas fillimit të pandemisë në muajin mars 2020,²⁴ si dhe pabarazitë e shfaqura sa i përket të ardhurave të punëtorëve, vlerësohet se kriza ka fuqinë të shtyjë edhe 25,000 njerëz të tjerë në varfëri relative dhe 100,000 njerëz

e numrit të papunëve gjatë pandemisë në industrinë e tekstilit“ (25 shkurt 2021) <<https://zmai.mk/зголемен-бројот-на-невработени-лица-в/>>.

18 Ibid.

19 Ibid.

20 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, grup sindikatash „ Proklamata e 1 Majit: punonjës dhe punonjëse, bashkohuni! Së bashku në luftën për të drejtat tona!“ (1 maj 2021) <<https://mhc.org.mk/news/prvomajski-proglas-rabotnichki-i-rabotnici-obednete-se-zaednichki-vo-borba-za-nashite-prava/>> qasja e fundit më 04.05.2021.

21 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut – prill-maj 2021“ (2021) < <https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshtaj-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedonija-april-maj-2021/>> qasja e fundit më 23.06.2021.

22 Nën 1.9 dollarë në ditë për person sipas paritetit të fuqisë blerëse. Shih më shumë Institutit për Kërkime Ekonomike dhe Politika Finance Think, „Sa Kovid-19 do të rrisë varfërinë në Maqedoninë e Veriut?“ (nëntor 2020) <<https://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2020/11/PB43-2.pdf>>.

23 Ibid.

24 Agjencia e Punësimit vetëm në qershor filloi të mbante statistika të ndara për fluksin e personave që kanë fituar statusin e personave të papunë, për të cilët u regjistrua tërheqja nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror në periudhën pas 11 marsit 2020. Këtu është paraqitur numri i përgjithshëm i njerëzve të papunë, duke filluar nga marsi i vitit 2021. Numri i personave të papunë për muajt mars, prill dhe maj, për të cilët APRM nuk ka mbajtur statistika të ndara në lidhje me krizën, është 21,838 persona. Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut. “Rishikimi i të dhënave për hyrjen dhe daljen e personave të papunë“ (2021) <<https://av.gov.mk/pregled-na-podatoci-za-priliv-i-odliv-na-nevработeni-lica.nspj>> qasja e fundit më 03.05.2021.

shtesë nën pragun e varfërisë absolute.²⁵ Në kushte të tilla, rreth 70 për qind e qytetarëve besojnë se me të ardhurat e tyre nga puna, paga, kursimet dhe të ardhurat e tjera në familje, ato mund të qëndrojnë deri në tre muaj,²⁶ dhe supozohet se e ardhura mesatare vjetore e disponueshme e një familje, pas përfundimit të krizës do të zvogëlohet për 7.2 për qind ose 38,341 denarë.²⁷

Rritja e vazhdueshme e ndarjeve klasore shuan solidaritetin e punëtorëve dhe dëshirën për veprim të organizuar dhe i drejton punëtorët drejt zhvillimit të një lufte individuale për realizimin e të drejtave të caktuara të punëtorëve. Kjo luftë individuale, karakteristikë e kapitalizmit modern, i bën të padukshëm një numër të madh punëtorësh të papunë, të tillë si punëtorët me kontratë në vepër, punonjësit e kujdesit joformal, punëtorët “e palajmëruar”, “amviset” dhe të ngjashme. Ata që janë vetëm punëtorë aktualë nuk konsiderohen ligjërisht të punësuar dhe nuk gëzojnë mbrojtje sistemike, dhe gjithashtu janë më të ekspozuar ndaj eksplotimit.²⁸ Në këtë mënyrë, ata janë jashtë çdo lufte të organizuar për të ushtruar të drejtat e tyre të punës.

Avancimi i të drejtave të punëtorëve dhe përmirësimi i gjendjes

së përgjithshme të punëtorëve vihen në plan të dytë, në hijen e mbrojtjes së të drejtave ekzistuese që shkelen për çdo ditë. Kriza shëndetësore e shkaktuar nga koronavirusi është treguesi më i mirë i pasojave dhe mungesës së ndonjë sigurie ose garancie për një trajtim dinjitoz të punëtorëve që nuk bashkohen. Në kushte të tilla, çorganizimi i punëtorëve dhe përçarja sindikale u ndie më së shumti, kështu edhe përfaqësimi dhe avokimi joadekuat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Kjo dëshmohet gjithashtu nga përpjekjet e pasuksesshme të sindikatave, të cilat edhe para krizës nuk gëzonin shumë besim, për të përfaqësuar në mënyrë adekuate interesat e punëtorëve dhe për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Qasja e tyre ilustron më së miri përmes veprimtarisë në lidhje me masat për mbështetjen e ekonomisë, në përgatitjen e së cilës përfaqësuesit e dhomave të tregtisë morën pjesë në mënyrë aktive dhe ishin të kënaqur që Qeveria pranoi një numër të madh të propozimeve të tyre.²⁹ Për dallim nga dhomat tregtare, kërkesat e sindikatave përfaqësuese që morën pjesë në takimet koordinuese nuk u morën parasysh dhe nuk u përfshinë në asnjë nga paketat e masave ekonomike.³⁰ Kjo tregon qartë se sindikatat “tradicionale” maqedonase,

25 Instituti për Kërkime Ekonomike dhe Politika Finance Think, „Sa Kovid-19 do të rrisë varfërinë në Maqedoninë e Veriut?“.

26 Instituti për Kërkime Ekonomike dhe Politika Finance Think, „Efektet ekonomike nga kriza e koronavirusit“ (prill 2020) <https://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2020/10/QLife_No.3.pdf>.

27 Instituti për Kërkime Ekonomike dhe Politika Finance Think, „Sa Kovid-19 do të rrisë varfërinë në Maqedoninë e Veriut?“.

28 Vildan Drpljanin, „Punëtorë të padukshëm“ (ResPublica, 2020) <<https://respublica.edu.mk/mk/blog/2020-10-26-11-16-26>> qasja e fundit më 03.05.2021.

29 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - dhjetor 2020“ (2020) <<https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshta%01%98-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-make-doni%01%98a-dekempri-2020/>> qasja e fundit më 04.05.2021.

30 Ibid.

edhe pas 30 vjetësh, nuk kanë merituar një vend të qëndrueshëm në tryezën e negociatave dhe ende nuk kanë fuqi të luftojnë për mbrojtjen e duhur të të drejtave të punëtorëve. Sindikatat përfaqësuese nuk arritën as të marrin një rritje të duhur të pagës minimale në vlerë prej 16,976 denarë.³¹ Pranimi paqësor i zgjidhjeve të tilla tregon varësinë akoma të pranishme të sindikatave nga bashkëpunimi me institucionet dhe politikanët, kur bëhet fjalë për negociata kolektive. Kjo më tej zvogëlon besimin tashmë të ulët të punëtorëve në sindikatat përfaqësuese dhe sindikatat e niveleve më të larta, veçanërisht sepse ata nuk i përfaqësojnë ata dhe rrallë janë të njohur me zhvillimet në terren.³²

Në një kohë kur të tre palët e partneritetit social - punëtorët, punëdhënësit dhe Qeveria - janë të prekur nga kriza shëndetësore dhe ekonomike,³³ vlen të merret në konsideratë se cila është pasqyra reale për sindikatat në këtë moment dhe çfarë duhet bërë për të kthyer lëvizjen sindikale në duart e punëtorëve. Prandaj, është e nevojshme të propozohen zgjidhje alternative që mund të çojnë në forcimin e fuqisë sindikale të punëtorëve, të tilla si, për shembull, përvetësimi i subjektivitetit juridik për të gjitha sindikatat, një çështje që do të shpjegohet më poshtë.

31 Në një seancë të Këshillit Ekonomik dhe Social mbi nevojën për të harmonizuar pagën minimale, anëtarët e përbërë nga punëdhënësit dhe Qeveria me 8 vota pro dhe 4 kundër, mbivotuan sindikatat ose punëtorët për shumën e harmonizimit të pagës minimale në përputhje me ligjin dhe në vend të shumës prej 16,976 denarë u miratua një shumë prej 15,190 denarë, si bazë neto për pagën minimale. Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë, “Në seancën e KES, punëtorët u mbivotuan për pagën e tyre minimale nga zyrtarët qeveritarë dhe punëdhënësit“ (31 mars 2021) <<https://www.ssm.org.mk/mk/na-sednica-na-ess-rabotnicite-nadglasani-za-nivnata-minimalna-plata-od-pretstavnicite-na-vladata-i>> qasja e fundit më 04.05.2021.

32 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017). Faqe 42.

33 Todor Kallamatiev, Aleksandar Ristovski, „Marrëdhëniet e punës në kushtet e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga Kovid-19“ (janar 2021) <<https://bit.ly/3h1LyGW>>.

QASJA METODOLOGJIKE

KËRKIMORE

QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij punimi është të formulojë një rekomandim specifik në lidhje me dilemën nëse secila sindikatë duhet të ketë statusin e një personi juridik dhe subjektivitetin e vet juridik.³⁴ Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, punimi do të kontribuojë në rregullimin e këtyre dispozitave në Ligjin e ri për Marrëdhëniet e Punës. Për më tepër, përgjigja në pyetjen mbi subjektivitetin juridik do të imponojë zgjidhje alternative për transformimin e sindikalizmit të abuzuar prej kohësh dhe do të kontribuojë në drejtimin e lëvizjes së hutuar sindikale në kahjen e duhur drejt solidaritetit dhe avancimit të përbashkët të të drejtave të punëtorëve.

PYETJE KËRKIMORE DHE TEZA

Duke analizuar sindikatën nga këndvështrimi i natyrës dhe qëllimit themelor të saj, lindin disa dilema. Njëra prej tyre është pyetja nëse funksioni themelor i sindikatës është të sigurojë shërbime ekonomike dhe juridike për anëtarët e saj, apo sindikata duhet të jetë kryesisht një mekanizëm përmes të cilit anëtarët e saj do të arrijnë qëllimet e përbashkëta për ndryshimin social dhe pjesëmarrjen në

³⁴ “Çdo sindikatë” nënkupton të gjitha llojet e sindikatave, pavarësisht nga mënyra e organizimit të tyre. Kjo do të thotë se përfshihen sindikatat në nivelin e punëdhënësit, e profesionit, degëve dhe sindikatat e përgjithshme. Ligji aktual përcakton subjektivitetin juridik vetëm për sindikatat e degëve dhe sindikatat e përgjithshme.

proceset demokratike.³⁵ Prandaj, ky punim kërkimor përpiqet të përgjigjet në dy pyetje të rëndësishme: cili është funksioni themelor i sindikatës sipas bindjeve të tyre personale dhe bazuar në faktin nëse të gjitha sindikatat duhet të kenë një subjektivitet të posaçëm juridik. Përgjigja e pyetjes së parë padyshim do t'i përgjigjet një pjese të së dytës, e cila do të hedhë më tej bazat për krijimin e politikave publike për të forcuar rolin e sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Hipoteza në të cilën përqendrohet ky kërkim shkencor është se mungesa e subjektivitetit juridik të të gjitha sindikatave çon në dy probleme kryesore: distancimin e punëtorëve nga sindikatat në nivel punëdhënësish dhe aneksimin e sindikatave të nivelit më të ulët nga forma më e lartë e sindikatave.³⁶ Përvetësimi i subjektivitetit juridik do të nënkuptojë rritjen e prezencës së sindikatave të nivelit më të ulët, e cila do të forconte më tej besimin e punëtorëve në lëvizjen sindikale dhe, së fundi, për të organizuar edhe klasën punëtore.

METODAT HULUMTUESE

Duke njohur nevojën për një analizë gjithëpërfshirëse të ndryshimeve që sjell Ligji i ri i Marrëdhënieve të Punës, ky punim përmes një qasje ndërdisiplinare do të marrë parasysh aspektet historike, ekonomike dhe sociale të të drejtave të punëtorëve në përgjithësi, si dhe lëvizjen sindikale, në veçanti, për të dhënë rekomandime të synuara për transformimin e sindikalizmit bashkëkohor maqedonas.³⁷

Të dhënat kryesore të hulumtimit u mblodhën përmes intervistave të thelluara me përfaqësues të 17 sindikatave në nivel të punëdhënësit, profesioneve, degëve dhe sindikatave të përgjithshme.³⁸ Intervistat janë realizuar me telefon dhe në formë të shkruar, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme gjatë përgatitjes së punimit.³⁹ Pyetjet e bëra përfaqësuesve të intervistuar të sindikatës ishin të llojit të hapur dhe të anketuarit kishin mundësinë të përgjigjen në mënyrë përshkruese, në mënyrë që rezultati i intervistave kërkimore të tregojë perspektivën e tyre që do të ishte përplot detaje. Transkripti i plotë i përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit mund të gjendet në Aneksin 1 të këtij hulumtimi. Për qëllimet e këtij hulumtimi, në tekstin bazë janë veçuar të dhënat kryesore.

35 Sigurisht, ekziston një mundësi që e vërteta të jetë diku në mes si një kombinim i dy çështjeve ose që qëllimi i sindikatës të jetë plotësisht një çështje e tretë, por për nevojat e këtij punimi dhe pyetjeve kërkimore, këto janë dy pikëpamjet më të rëndësishme. Më tepër mbi këto dilema mund të lexohet në Child J, Loveridge R and Warner M, "Towards an Organizational Study of Trade Unions" (1973) 7 Sociology 71.

36 Vildan Drpljanin, „Kush dhe si po (do të) i organizon sindikatat?“ (ResPublica, 2019) <<https://respublica.edu.mk/blog/2019-09-11-08-39-41>> qasja e fundit më 18.03.2020.

37 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017).

38 Të gjitha sindikatat që iu përgjigjën ftesës janë renditur në fillim të këtij punimi në seksionin "Shënime të veçanta".

39 Më 11.03.2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli pandeminë për shkak të sëmundjes Covid-19. Më 18.03.2020, Republika e Maqedonisë së Veriut shpalli gjendje të jashtëzakonshme në territorin e gjithë vendit.

Subjekti i këtij hulumtimi dhe arritja e qëllimit të tij janë zotëruar me sukses duke përdorur metodat themelore të kërkimit: analiza e dispozitave mbi subjektivitetin juridik të sindikatave në Ligjin aktual për Marrëdhëniet e Punës dhe dispozitat e propozuara në ligjin e ri. Ato janë interpretuar në përputhje me kuptimin e zakonshëm të fjalëve të përdorura, duke marrë parasysh kontekstin në të cilin zbatohet ligji aktual dhe në të cilin duhet të miratohet ligji i ri. Fuqia asimetrike midis sindikatave të nivelit më të lartë dhe sindikatave “më të ulëta” në ligjërimitin e subjektivitetit të tyre juridik është shqyrtuar dhe analizuar në mënyrë kritike në pjesën e dytë të hulumtimit. Të dhënat kryesore janë analizuar në mënyrë cilësore dhe kuptimi i tyre është shpjeguar në detaje, përmes fragmenteve të kategorizuara të intervistave me të anketuarit, pa ndryshuar asgjë nga deklaratat e tyre origjinale. Për më tepër, punimi në versionin e tij përfundimtar u dërgua për recensë të dy nga katër sindikatat kombëtare - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura dhe Autonome të Maqedonisë (BSPAM) dhe Konfederata e Organizatave Sindikale të Maqedonisë (KOSM). Vështrimet e tyre janë analizuar dhe futur në seksionet përkatëse.

Duke përdorur metodat e mësipërme të hulumtimit, punimi do të tregojë se si sindikatat mbështeten në argumente pothuajse identike për të provuar dy këndvështrime krejtësisht të ndryshme sa i përket subjektivitetit juridik të të gjitha sindikatave. Autorët e këtij punimi do të japin mendimet e tyre për peshën e këtyre argumenteve dhe anën që ata mbështesin në të vërtetë.

STRUKTURA E PUNIMIT

Pjesa e parë e këtij punimi do të shqyrtojë aspektet historike, ekonomike dhe sociale të lëvizjes sindikale në Maqedoni në të kaluarën dhe kushtet që mundësuan krijimin e statukuosë ekzistuese. Kjo pjesë do të ofrojë gjithashtu një analizë krahasuese të rregullimit ligjor të sindikatave në të kaluarën dhe sot. Pjesa e dytë adreson gjendjen aktuale të statukuosë në të cilën vetëm sindikatat e nivelit më të lartë kanë subjektivitet juridik, siç parashikohet aktualisht nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës. Zgjidhjet e reja ligjore të propozuara që do t'u jepnin të gjitha sindikatave statusin e një personi juridik janë analizuar në pjesën e tretë, në të cilën autorët do të ofrojnë argumente për të sfiduar këtë statukuo. Së fundmi, punimi ofron vëzhgime përfundimtare, me rekomandime konkrete nëse secila sindikatë duhet të ketë statusin e një personi juridik dhe subjektivitetin e vet juridik.

DREJT STATUKUOSË SË

SINDIKALIZMIT

EVOLUCIONI I SINDIKATAVE NË MAQEDONI

Punëtorët e hekurudhës maqedonase të cilët në pranverën e vitit 1900 në hekurudhën Veles-Demir Kapi hynë në grevë për paga më të larta dhe shkurtimin e orëve të gjata të punës, me siguri lëshuan thirrjen e parë për bashkimin e punëtorëve të organizuar maqedonas.⁴⁰ Ndërprerja masive e punës, e organizuar nga organizata lokale socialiste e Velesit në linjat hekurudhore Selanik-Shkup-Prishtinë,⁴¹ Mbyllja masive, e organizuar nga

organizata lokale socialiste nga Velesi në linjat hekurudhore Selanik-Shkup-Prishtinë, kishte zgjatur dy ditë dhe kishte pamundësuar plotësisht trafikun e udhëtarëve dhe të mallrave në seksionin e rrugës Selanik-Shkup.⁴² Kryesisht grevistët e rinj patën sukses në kërkesat e tyre dhe ky shembull inkurajoi më tej edhe minatorët e Shkupit, rrobaqepësit e Strumicës, kultivuesit e duhanit në Dibër,⁴³ këpuçarët(et) e Manastirit dhe punëtorët e tjerë nëpër qytete të tjera të bëjnë grevë për kushte më të mira të punës.⁴⁴

40 Ivanovski, Todorovski, Lazarov, Petkovski, Janev dhe Dimitrievski, *Historiku i lëvizjes sindikale në Maqedoni* (Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë 2008).

41 Të dhënat e konfirmuara nga dokumentet në lidhje me organizimin e punëtorëve në Maqedoni, të disponueshme në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare „Sh. Kliment Ohridski“, data e kontrollit: 3.7.2020.

42 Ivan Katarxhiev, Ivan Mazov dhe Sllavko Mandiçeski, *Artikuj të zgjedhur mbi lëvizjen punëtore dhe socialiste në Maqedoni* (1962).

43 Orde Ivanovski, *Lëvizja sindikale e punëtorëve në Maqedoni deri në vitin 1918* (Komunist, 1985).

44 Të gjitha këto grupe punëtorësh organizuan grevat e tyre në periudhën midis fundit të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të

Në fund të vitit 1908 dhe fillimin e vitit 1909, u krijuan sindikatat e para ligjore maqedonase, duke përfshirë sindikatën e përzier në Shkup, ku ishin anëtarësuar punëtorë të bashkësive të ndryshme etnike.⁴⁵ Një nga sukseset më të mëdha të këtyre sindikatave është festimi i parë i Ditës së Punës,⁴⁶ 1 Maji i vitit 1909, dhe vendosja e praktikës së shënimit të përvjetshëm të kësaj dite.⁴⁷ Duke pasur parasysh se klasa punëtore në atë kohë përbëhej nga fshatarësia proletare,⁴⁸ zejtarët,⁴⁹ esnafët dhe numri i vogël i punëtorëve industrialë,⁵⁰ eksploatimi i pamëshirshëm ishte motivi kryesor për organizimin sindikal.

Në periudhën midis dy luftërave botërore, nga viti 1919 deri në vitin 1939, lëvizja punëtore, në përputhje me ndryshimet shoqërore dhe politike, mori një kurs të ri zhvillimi.⁵¹ Zgjerimi i lëvizjes sindikale u bë nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të socialistëve dhe lindi nga themelimi i organizatave të partisë, respektivisht bashkimit të lëvizjeve të punëtorëve të popujve jugosllavë në një parti të vetme politike dhe sind-

ikatë klasore. Momenti përcaktues për lëvizjen e punëtorëve në atë periudhë ishte miratimi i dekretit diktatorial “Obznana (Njoftim)” në Jugosllavinë mbretërore,⁵² i cili ishte baza për përplasje me disidentët politikë dhe në të njëjtën kohë ndaloi çdo organizatë punëtore dhe organizim sindikal.⁵³ Para dekretit, sindikatat në mbretëri funksiononin në një organizatë të vetme nën emrin Këshilli Qendror Sindikal i Punëtorëve të Jugosllavisë (KQSPJ), e formalizuar në kongresin e parë të Partisë Socialiste Jugosllave të Punës nga 22 deri 23 prill 1919.⁵⁴ Në KQSPJ ishin të anëtarësuar mbi 200.000 punëtorë, kurse sindikata ishte në kontroll të rreptë të partisë përkundër fraksioneve të fuqishme komuniste, por dekreti ndalonte dhe kriminalizonte aktivitetin e sindikatës madje edhe të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ). Dekreti ishte miratuar në dhjetor të vitit 1920 dhe ai kishte shfuqizuar marrëveshjet kolektive, kishte ulur mëditjet e punëtorëve për 1/3 dhe kishte zgjatur orarin e punës në dhjetë e më shumë orë.⁵⁵

20-të. Të dhënat e konfirmuara nga dokumentet në lidhje me organizimin e punëtorëve në Maqedoni, të disponueshme në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare „Sh. Kliment Ohridski“, data e kontrollit: 3.7.2020.

45 Orde Ivanovski, Mile Todorovski, Lazar Lazarov, Borislav Petkovski, Jovan Manev dhe Marjan Dimitrievski, *Historiku i lëvizjes sindikale në Maqedoni* (Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë 2008).

46 Deri në vitin 1908, punëtorët maqedonas nuk kishin të drejtë të organizoheshin dhe të vepronin ligjërisht. Grevat u ndaluan dhe grevistët u persekutuan dhe u ndëshkuan.

47 Të dhënat e konfirmuara nga dokumentet në lidhje me organizimin e punëtorëve në Maqedoni, të disponueshme në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare „Sh. Kliment Ohridski“, data e kontrollit: 3.7.2020.

48 Fshatarë që ishin kryesisht bujq.

49 Tregtarë dhe zanatçinj ndihmës.

50 Kryesisht mjeshtër që punonin me vegla.

51 Orde Ivanovski, Mile Todorovski, Lazar Lazarov, Borislav Petkovski, Jovan Janev dhe Marjan Dimitrievski, *Historiku i lëvizjes sindikale në Maqedoni* (Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë 2008).

52 Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation, 1918-2005* (Woodrow Wilson Center Press; Indiana University Press 2006).

53 Autoritetet kishin frikë se në situatën e atëhershme politike, protestat e punëtorëve përbënin një rrezik që mund të përshkallëzohej në një konflikt të hapur në mbretëri.

54 Fred Singleton, *A Short History of the Yugoslav Peoples* (Cambridge University Press 1985).

55 Sabrina P. Ramet, *The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation, 1918-2005* (Woodrow Wilson Center Press; Indiana

E gjithë kjo ishte arsyeja për organizimin masiv të grevave dhe promovimin e kërkesave në lidhje me orët e punës, mëditjet, marrëveshjet kolektive, kushtet e punës dhe eksploatimin nga ana e punëdhënësve. Në periudhën pas dekretit, në territorin e Maqedonisë vepronin kryesisht degët e dy organizatave sindikale. Këto ishin Sindikatat e Pavarura të Jugosllavisë (SPJ),⁵⁶ të cilat për shkak të një ndalimi të ri sepse ishin nën ndikimin e PKJ-së në vitin 1925 u regjistruan sërish si sindikata URSO-VI, si dhe Lidhja e Sindikatave të Jugosllavisë (LSJ).⁵⁷ Megjithëse ishin të natyrshme ndalimet e sindikatave në ato vite, të tilla si diktatura e 6 janarit 1929-1931 ose ndalimet e qeverisë Cvetkoviç-Maçek në vitin 1940 në periudhën midis dy luftërave botërore, territori i Maqedonisë së sotme ishte pothuajse gjithmonë i mbuluar nga një rrjet sindikatash. Industria ishte kryesisht e pazhvilluar, por punëtorët në industrinë e metaleve dhe punëtorët e hekurudhës, kamerierët, rrobaqepësit dhe marangozët ishin më mirë të organizuar.⁵⁸

Megjithatë, sindikatat ishin të pafuqishme t'i kundërviheshin grabitjes dhe eksploatimit shoqëror-ekonomik të punëtorëve në atë kohë përmes sistemit të kuponëve dhe sistemit të spahi. Prandaj, është

mjaft e natyrshme që shumë punëtorë e panë zgjidhjen e padrejtësive sociale, përfshirë ato të punëtorëve, në thirrjen e PKJ-së për kyçje në aradhet partizane në vitin 1941. Shumica e anëtarëve të aradheve partizane nga Maqedonia ishin përpunues metali, elektrikistë, rrobaqepës dhe marangozë, prandaj nuk është për t'u habitur që disa nga emrat më të mëdhenj maqedonas, në kuptimin e sotëm të fjalës, ishin udhëheqës të sindikatës. Vera Aceva, Cvetan Dimov, Orce Nikolov, Bajram Shabani dhe Rade Jovçevski-Korçagin njihen si partizanë, por para luftës ata ishin organizatorë të grevave dhe luftëtarë për drejtësi sociale.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në dhjetor të vitit 1944 në Shkup u mbajt konferenca e parë zyrtare e përfaqësuesve të klasës punëtore, kurse në janar të vitit 1945 u mbajt një tubim i përgjithshëm i punëtorëve. Në Maqedoni, u formua një Bordi Sindikal për Veprim, dhe në të gjitha qytetet u formuan këshillat lokale, të organizuara nga punëtorët në sindikatat e tyre të profesionit. Sindikatat ishin të përfshira në mënyrë të padiskutueshme në rindërtimin e vendit dhe morën pjesë në mënyrë aktive në miratimin dhe zbatimin e Ligjit për Reformën dhe Kolonizimin Agrar⁵⁹ dhe Ligjin për Shtetëzimin.⁶⁰ Me këto

University Press 2006).

56 Kjo sindikatë u themelua në 27 dhjetor 1921 si MSO (Bordi Ndërkrahinor i Sindikatës) prej 12 sindikatash që ishin aktive para ndalimit në vitin 1920 me emrin CRSVJ (Këshilli Qendror Sindikal i Punëtorëve të Jugosllavisë). Kjo sindikatë ishte me natyrë revolucionare dhe komuniste

57 Themeluar në vitin 1922 nga socialistët e qendrës dhe reformistët.

58 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017).

59 Ligji për Reformën Agrare dhe Kolonizimin („Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Maqedonisë“ nr. 3/1946) miratuar më 09.02.1946, në fuqi nga data 17.03.1946.

60 Ligji i Nacionalizimit („Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federale të Jugosllavisë nr. 98/II), miratuar më 05.12.1946, në fuqi më 06.12.1946.

ligje u shfuqizuan mbetjet feudale të ekonomisë bujqësore dhe toka iu dha fshatarëve që e kultivonin atë. Ky është vetëm një episod i thesarit të pasur të historisë së sindikatave në periudhën nga viti 1944 deri në vitin 1991, kur Maqedonia, si pjesë e RSF të Jugosllavisë, kishte një lëvizje dhe klasë të zhvilluar punëtore dhe klasa punëtore e konsideroi atë periudhë një pikë kthese, sepse ishte vendosur sistemi vetëqeverisës.

Ky sukses i lëvizjes së punëtorëve në shekullin e 20-të është degraduar plotësisht në tranzicionin post-socialist, në të cilin qindra mijëra punëtorë u zhytën në varfëri të thellë në kurriz të disa oligarkëve që u bënë multimilionerë. Periudha nga vitet tetëdhjetë deri në vitet e 2000-ta në Maqedoni nuk mund të karakterizohet nga asgjë tjetër, përpos pakënaqësive masive të punëtorëve, grevave dhe protestave të kompanive humbëse të cilat në vitin 2002 ishin një nga tubimet më të organizuara dhe radikale të punëtorëve në Maqedoni. Me fillimin e procesit të privatizimit, tranzicionit të marrëdhënieve shoqërore dhe zhvillimit të pluralizmit politik, filloi edhe transformimi i Sindikatës Komuniste të Maqedonisë - Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM). Në vitin 1990 u mbajt Kongresi i 13-të i LSM-së, i cili konfirmoi nevojën për të ndërtuar një sindikatë që do t'i përgjigjej shoqërisë së re dhe

në Kongresin e saj të Katërbëdhjetë në vitin 1993, LSM-ja themeloi pozicionin e saj autonom dhe të pavarur, i cili pozicion u forcua më tej në Kongresin e Pestë të mbajtur në vitin 1997. Statutet dhe programet e miratuara në këto kongrese promovojnë LSM-në dhe sindikatat e saj të bashkuara si organizata të pavarura, jo-qeveritare, jo-partizane të punëtorëve për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre sociale, ekonomike dhe kulturore.⁶¹

VLERËSIMI HISTORIK DHE KRAHASUES I ORGANIZIMIT SINDIKAL

120 vitet e fundit, në të cilët është dokumentuar lëvizja punëtore maqedonase, japin një përshkrim të mirë të pikave të forta dhe të dobëta të organizatës sonë kolektive. Tranzicioni është padyshim një nga arsyet kryesore për gjendjen e dobët të të drejtave të punëtorëve sot, sepse ai e ka mposhtur plotësisht lëvizjen punëtore në Maqedoni, por është e pashmangshme edhe fakti që historikisht tradita e sindikalizmit është zhvilluar më ngadalë për shkak të industrializimit të ulët. Për shembull, sindikatat evropiane,⁶² të tilla si ajo e formuar në vitin 1818 nga punëtorët përgjegjës me makiner-

61 Tome Georgievski, *Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridiko-politike* (2000) 8.

62 Sindikatat që mbuluan të gjitha degët e punës, pavarësisht nga aftësitë ose profesioni, ekzistuan për një periudhë kohe në shumicën e vendeve të industrializuara. Në Britani, ku ata luajtën një rol më të madh në organizimin modern të sindikatave se kudo tjetër, ata u krijuan që në shekullin e 19-të. Shih Eric J. Hobsbawm, *Labouring men: Studies in the History of Labour* (first published 1964, Anchor Books 1967) 211. Sindikalizmi britanik arriti kulmin e tij midis viteve 1950 dhe 1975, të cilin Hobsbawm e quajti "Epoka e Artë". Shih Eric J. Hobsbawm, *Age of Extremes: The Short Twentieth Century 1914-1991* (first published 1994, Abacus Books 1995) 257-286.

itë e pambukut në Mançester, Angli,⁶³ për shkak të kushteve të tmerrshme dhe pagave të ulëta, janë gati një shekull përpara sindikalizmit maqedonas. Përkundër këtyre ndryshimeve, si dhe nevojave të ndryshme shoqërore të krijuara nga kalimi i dy shekujve që nga ajo kohë,⁶⁴ premisa themelore për bashkimin e punëtorëve mbetet e njëjtë edhe sot, si në Mbretërinë e Bashkuar ashtu edhe në Maqedoni.⁶⁵ Ekzistenca e sindikatave lind direkt nga nevoja e punëtorëve për të qenë të organizuar, të bashkuar dhe solidarë në luftën për të drejtat e tyre të punës.⁶⁶ Kjo nevojë është baza e ekzistencës, pavarësisht nëse bëhet fjalë për pagat dhe orarit të punës,⁶⁷ me anë të marrëveshjeve kolektive si arritja më e madhe e luftës sindikale ose ndonjë kushti tjetër pune dhe jetese që prekin punëtorët.⁶⁸

Prandaj, baza e ekzistencës së sindikatave në Maqedoni buron nga Kushtetuta.⁶⁹ Akti më i lartë juridik u garanton qytetarëve lirinë e asociimit për realizimin e të drejtave dhe bindjeve të tyre politike, ekonomike,

sociale, kulturore dhe të tjera.⁷⁰ Ky përcaktim specifikohet më pas në nenin 37 të Kushtetutës, i cili përcakton se qytetarët kanë të drejtë të formojnë sindikata për të ushtruar të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale dhe shprehimisht thotë se sindikatat mund të krijojnë unionet/bashkimet e tyre dhe mund të anëtarësohen në organizata sindikale ndërkombëtare.⁷¹

Në të kaluarën, pozicioni i sindikatave ishte rregulluar më specifikisht nga Ligji i parë i Marrëdhënieve të Punës i vitit 1993,⁷² i cili i kushtoi tetë nene organizimit sindikal, por nuk ka përmendur në mënyrë të qartë legjitimitetin juridik të sindikatës. Prandaj, baza ligjore për ushtrimin e funksionit mbrojtës të lidhjeve të sindikatave, sindikatave të degëve dhe sindikatave rajonale lindi nga dispozitat e nenit 134,⁷³ si dhe nenit 137 të Ligjit,⁷⁴ por edhe nga Udhëzimi për të vepruar ndaj kërkesave të anëtarëve të sindikatës ofrimin e mbrojtjes juridike.⁷⁵ Kështu, për të ushtruar të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës,

63 Robert G. Hall, "Tyranny, Work and Politics: The 1818 Strike Wave in the English Cotton District" (1989) 34 *International Review of Social History* 433, 433.

64 Si për sa i përket jetës së përditshme, ashtu edhe për sa i përket organizimit sindikal dhe nevojave të punëtorëve dhe punëdhënësve. Më shumë shpjegohet në Gregor Gall, *The International Handbook of Labour Unions: Responses to Neo-Liberalism* (Elgar 2011) 84-89.

65 Më detajisht e shpjeguar në Doellgast VL, Lillie N and Pulignano V, *Reconstructing Solidarity: Labour Unions, Precarious Work, and the Politics of Institutional Change in Europe* (First edition, Oxford University Press 2018) 83-100.

66 Michael Yates, *Why Unions Matter* (2nd ed, Monthly Review Press 2009) 31-37.

67 Michael Yates, *Why Unions Matter* (2nd ed, Monthly Review Press 2009) 47-52.

68 Tome Georgievski, *Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridiko-politike* (2000) 15.

69 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/1991).

70 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 20 paragrafi 1.

71 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 37 paragrafi 1.

72 Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 80/93 nga 30.12.1993).

73 Ligji për Marrëdhëniet e Punës (1993), neni 134: Gjatë ushtrimit të të drejtave individuale nga punësimi, punëtori ka të drejtë të kërkojë mbrojtje nga punëdhënësi, para gjykatës kompetente, sindikatës, organeve të inspektimit dhe organeve të tjera, në përputhje me ligjin.

74 Ligji për Marrëdhëniet e Punës (1993), neni 137: Organi kompetent është i detyruar, para se të marrë vendimin mbi kërkesën, pra pas ankesës së punonjësit, të kërkojë një mendim nga sindikata në të cilën punonjësi është anëtar dhe ta shqyrtojë detyrimisht atë dhe të deklarohet për të, nëse sindikata ka paraqitur një mendim.

75 Tome Georgievski, *Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridiko-politike* (2000) 112-117.

anëtarët e sindikatës kishin të drejtë të kërkonin mbrojtje ligjore nga Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë. Mbrojtja ligjore përfshinte sigurimin e këshillave ligjore, përgjegje dhe sqarime të ekspertëve, hartimin e parashtresave dhe përfaqësimin para organeve drejtuese të kompanive, institucioneve dhe punëdhënësve të tjerë dhe para organeve gjyqësore dhe inspektuese. Në këtë mënyrë, sindikata në praktikë ushtronte kompetencën dhe përgjegjësinë e saj për të forcuar pozicionin juridik të punëtorëve, i cili teorikisht lindi nga subjektiviteti juridik i paracaktuar.

STRUKTURA JURIDIKE E SINDIKATAVE SOT

Në vitin 2005 u miratua një Ligj i ri i Marrëdhënieve të Punës (LMP),⁷⁶ i cili është ende në fuqi. Ky ligj sot përcakton se vetëm sindikata në një nivel më të lartë fiton statusin e një personi juridik ditën e regjistrimit në Regjistrin Qendror, pas regjistrimit paraprak në Regjistrin e Sindikatave.⁷⁷ Regjistri i Sindikatave menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale⁷⁸ dhe sipas të dhënave më të fundit nga data

31.03.2021, Regjistri numëron 65 sindikata të regjistruara.⁷⁹

Në një rregullim të tillë, sindikatat “më të ulëta” nuk mund të kenë llogarinë e transaksionit dhe vulën e tyre, dhe nuk mund të veprojnë në qarkullimin juridik në cilësinë e një subjekti juridik.⁸⁰ Sindikata në një situatë të mungesës së subjektivitetit juridik pengohet drejtpërdrejt, si person juridik, të paraqesë një padi në një gjykatë kompetente. Legjitimiteti aktiv për ngritjen e një procesi gjyqësor në këtë rast kalon në sindikatën e një niveli më të lartë, brenda të cilit është bashkuar sindikata “më e ulët”.⁸¹ Prandaj, rregullimi i dispozitave mbi sindikatat, liria e asociimit në marrëdhëniet e punës dhe kuadri nën të cilin zhvillohet procesi i negociatave kolektive dhe greva, ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat po përgatitet ky punim - në kohën kur po intensifikohet hartimi i Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Punës, i cili së shpejti duhet të jetë në Kuvend, dhe kjo është një mundësi e mirë për të diskutuar mbi këto çështje.

Të drejtat e punëtorëve fillojnë dhe shpesh përfundojnë brenda vendit të punës. Organizimi i punëtorëve, respektivisht organizimi sindikal është gjithmonë i kushtëzuar nga rrethanat socio-ekonomike dhe sociale

76 Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 110/19).

77 Ligji për Marrëdhëniet e Punës, neni 189.

78 Ligji për Marrëdhëniet e Punës, neni 190 paragrafi 1.

79 Regjistri i sindikatave është në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, <<http://www.mtsp.gov.mk/registri.nsp>> qasja e fundit më 18.03.2020.

80 Kjo është e një rëndësie të veçantë në ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore të së drejtës për t'u bashkuar në sindikata.

81 Vildan Drpljanin, „Kush dhe si po (do të) i organizon sindikatat?“ (ResPublica, 2019) <<https://respublica.edu.mk/blog/2019-09-11-08-39-41>> qasja e fundit më 18.3.2020.

të shoqërisë së caktuar.⁸² Marrëveshjet kolektive, mbrojtja ligjore e punëtorëve dhe greva janë aktivitete që pasqyrojnë strategjinë e organizimit modern të një sindikate.⁸³ Ky punim përqendrohet në rolin e sindikatave në marrëdhëniet e punës, me një theks të veçantë në mbrojtjen ligjore të të drejtave të punëtorëve, përmes

prizmit të subjektivitetit juridik të sindikatave. Prandaj, është e nevojshme të hulumtohen dhe të pyeten sindikatat që na përfaqësojnë, cili është pozicioni i tyre në lidhje me çështjen nëse secila sindikatë duhet të ketë statusin e një personi juridik dhe subjektivitetin e saj juridik.

82 Tome Georgievski, *Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridiko-politike* (2000) 18.

83 Tome Georgievski, *Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridiko-politike* (2000) 9.



- PJESA E PARË -



SUBJEKTIVITET JURIDIK VETËM PËR SINDIKATËN E NIVELIT MË TË LARTË



Shkalla e organizimit sindikal në Maqedoni është 21,6 përqind,⁸⁴ që është pothuajse afër mesatares globale prej 23,81 përqind,⁸⁵ por dukshëm nën mesataren e Bashkimit Evropian prej 29,76 përqind.⁸⁶ Sidoqoftë, nëse shikohet vetëm në shkallën e organizimit sindikal, krijohet përshtypja se sindikatat maqedonase nuk mbeten shumë prapa partnerëve të tyre rajonalë dhe botërorë.⁸⁷ Raporti është shumë më i keq nëse shikoni situatën në kuptimin e thelbit të punës së sindikatave në vend.⁸⁸

Sindikatat, si mekanizëm mbrojtës, gëzojnë besimin më të ulët midis punëtorëve gra dhe burra, madje rreth 73.8 përqind e anëtarëve,⁸⁹ janë deklaruar se nuk ishin aspak të kënaqur me punën e sindikatave.⁹⁰ Shumica i konsiderojnë sindikatat të jenë joefikase, të korruptuara dhe/ose kolaboracioniste me pronarët e fabrikave.⁹¹ Në mënyrë indikative, shumica

e këtyre problemeve mund t'i atribuohen statusit juridik të sindikatave, por gjithashtu drejtpërdrejt vullnetit dhe aftësisë së tyre për të siguruar mbrojtjen e duhur.⁹²

Në këtë drejtim, kushtëzimi praktik i sindikatave për t'u bashkuar në mënyrë që të fitojnë statusin e një personi juridik në mënyrë që të kenë llogarinë e tyre, të vulosin dhe të jenë në gjendje të padisin, është një shpatë me dy tehe.⁹³ Nga njëra anë, sindikatat inkurajohen të konsolidohen dhe formojnë sindikata më të mëdha, por në të njëjtën kohë sindikatat dhe sindikatat e nivelit të punëdhënësve janë privuar nga shumë mundësi për shkak të mungesës së statusit të personit juridik. Ky pozicion i Ligjit të Marrëdhëniesve të Punës në këtë moment është një element kryesor që dikton bazat e organizimit sindikal dhe marrëdhëniet midis sindikatave.



84 Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 39.

85 ILOSTAT, 'Industrial relations', Summary Reports, <<https://bit.ly/2SYvgD3>> qasja e fundit më: 27.3.2020.

86 ILOSTAT, 'Industrial relations', Summary Reports, <<https://bit.ly/2SYvgD3>> qasja e fundit më: 27.3.2020.

87 Për analizë më të detajuar shih Valerija Botrić, "Structural unemployment and its determinants in Southeast Europe" (2011) *Ekonomiska misao i praksa* (1), 81-100.

88 Si ilustrim, një tregues i mirë është raporti vjetor i punës në vend, shih Friedrich Ebert Foundation, "Annual review of labour relations and social dialogue" (2018) <<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/bratislava/15359.pdf>> qasja e fundit më 27.3.2020.

89 Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 41. Studimi nuk përfshin një shembull përfaqësues, por gjetjet e analizës janë mjaft indikative për të arritur në përfundimin se sindikatat nuk gëzojnë shumë besim të punëtorët.

90 Nëse shtohen "pjesërisht të pakënaqurit", atëherë arrijmë në një shifër marramendëse prej 86.1 përqind.

91 Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 41.

92 Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 42-45.

93 Një dilemë juridike, dekada e vjetër në literaturë, shiko Simpson RC, "The Significance of the Legal Status of Trade Unions in Britain and Australia" (1976) *18 Journal of Industrial Relations* 229, 229-242.

1.1. MUNDËSITË PËR ORGANIZIM SINDIKAL DHE LUFTA PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Sindikatat në nivelin e punëdhënësit, si grupe joformale sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, theksojnë qartë se ato kanë nevojë për një subjektivitet të veçantë juridik në mënyrë që të mund të avancojnë punën e tyre.⁹⁴ Sidoqoftë, disa sindikata besojnë se statusi juridik nuk është aspak i rëndësishëm, por se:

fuqia [...] e sindikatave nuk buron nga statusi i tyre juridik ose (mos) zbatimi i ligjeve ekzistuese, por nga shkalla e gatishmërisë së anëtarëve të saj - punëtorëve (ose, në rastin e një lidhje sindikatash, gatishmëria individuale e secilit anëtar-sindikata) që të organizohen dhe të luftojnë së bashku për kushte më të mira të përbashkëta.⁹⁵

Kjo ngre pyetjen se si atëherë subjektiviteti juridik mund të ofrojë mbrojtje më të madhe kur ai nuk paraqet një përgjigje ndaj sfidave kryesore me të cilat përballen sindikatat? Sidoqoftë, në pyetjen e qartë se si subjektiviteti juridik mund të ofrojë mbrojtje më të madhe, përfaqësuesi i sindikatës specifike në nivelin e punëdhënësit deklaroi se statusi juridik është i nevojshëm sepse “sindikata është një identitet i veçantë politik dhe organizativ [i cili] duhet të ketë cilësinë e një personi juridik, siç janë edhe llojet e tjera të organizatave”.⁹⁶

Në të njëjtën mënyrë, përfaqësuesit e tjerë të sindikatës në nivelin e punëdhënësit konsiderojnë se subjektiviteti juridik është i nevojshëm për shkak të “rëndësisë së sindikatës”,⁹⁷ si dhe për shkak të “obligimit për të vepruar në përputhje me të gjitha aktet ligjore për punët financiare dhe punësimin”.⁹⁸ Është e qartë që të tri sindikatat po shohin një ndryshim pozitiv në lidhje me subjektivitetin e tyre të mundshëm juridik, por duket se nuk po u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme rreziqeve që mund të paraqiten. Për shembull, heqja e kushtëzimit që sindikatat duhet të bashkohen praktikisht për të fituar statusin e një personi juridik përmes një forme më të lartë të sindikatës mund të rezultojë në shpërbërjen e organizatës sindikale. Nëse sindikatat nuk duhet të bashkohen në sindikatat ekzistuese të një niveli më të lartë në mënyrë që të jenë në gjendje të kryejnë funksionin e tyre pa probleme, atëherë a do të ketë ende nevojë për bashkimin e organizimit sindikal?

Për më tepër, fakti që sindikatat e niveleve të ulëta nuk mund të kenë lloga-

94 E kuptueshme nga intervistat me sindikatat pranë Eriden DOOEL, KB Pelagonija dhe Posta e Maqedonisë – Filiali Kumanovë.

95 Sindikata e punëtorëve e ERIDEN DOOEL – Manastir, përfaqësues: Gorast Muratovski – anëtar i Këshillit ekzekutiv.

96 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e punëtorëve pranë ERIDEN DOOEL – Manastir, përfaqësues: Gorast Muratovski – anëtar i Këshillit ekzekutiv.

97 E kuptueshme nga intervista me Këshillin sindikal të KB Pelagonija AD – Manastir, përfaqësues: Mendo Milevski – kryetar.

98 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Postës së Maqedonisë Shkup – Filiali Kumanovë, përfaqësuese: Svetlana Bozhinovska – anëtare e Këshillit qendror.

rinë e tyre të transaksionit dhe të vulosin dhe veprojnë si një person juridik nuk do të thotë domosdoshmërisht që veprimet e tyre janë penguar. Është e padiskutueshme që këto parakushte kanë një rëndësi të veçantë në ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore,⁹⁹ por sindikata si individ/subjekt është një institut shumë më i madh dhe aktivitetet e saj janë shumë më gjithëpërfshirëse sesa ‘parashtrimi’ i padive në gjykatë. Legjitimiteti aktiv për ngritjen e një padie gjyqësore sipas statukuosë i kalon sindikatës së nivelit më të lartë, brenda të cilës është bashkuar sindikata, që do të thotë se sindikatat e ulta mund ta përdorin ende atë mundësi, por vetëm përmes një kanali tjetër. Duke pasur parasysh se përgjegjësia e sindikatave të niveleve më të larta është një tipar kryesor i sistemit aktual, është e rëndësishme të merren parasysh edhe pikëpamjet e tyre në mënyrë që të shqyrtohet nevoja për ndryshime të mundshme.

1.2. DEBAT TEORIK - IMPLIKIME THELBËSORE

Agro-sindikata, si një shembull që përputhet plotësisht me një nga sindikatat e saj në nivelin e punëdhënësit,¹⁰⁰ gjithashtu thekson nevojën për një status të veçantë juridik të sindikatave.¹⁰¹ Ndër të tjera, sindikata nuk hyn në një vlerësim më specifik të anëve pozitive dhe negative të këtij ndryshimi, por vetëm thotë se të gjitha sindikatat ‘duhet’ të kenë subjektivitetin e tyre juridik.¹⁰² Nga ana tjetër, SPITLK me përgjigje pothuajse njësoj të shkurtër, por krejt të kundërt, beson se statusin e një personi juridik duhet ta kenë vetëm sindikatat e degëve dhe sindikatat e përgjithshme, por jo edhe organizatat sindikale.¹⁰³ Mbështetjet e dobëta të përgjigjeve të tilla diametralisht të kundërta mund të nënkuptojnë që sindikatat nuk e konsiderojnë këtë çështje veçanërisht të rëndësishme për sa i përket rolit të tyre. Sidoqoftë, mungesa e interesit mund të jetë edhe për shkak të natyrës kryesisht teorike të kësaj dileme dhe mungesës së njohjes me implikimet reale që zgjidhja e mundshme do të reflektonte në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.¹⁰⁴

Sindikatat, të tilla si SPASHK dhe SPA, të cilat i qasen kësaj çështje nga

99 Për shkak të faktit se sindikata në një situatë të mungesës së subjektivitetit juridik është parandaluar drejtpërdrejt si një person juridik për të ngritur një padi në gjykatën kompetente.

100 Këshilli Sindikal pranë KB Pelagonija AD – Manastir.

101 E kuptueshme nga intervista me Agro-sindikatën.

102 E kuptueshme nga intervista me Agro-sindikatën.

103 E kuptueshme nga intervista me me Sindikatën e Punëtorëve në Industrinë e Tekstilit, Lëkurës dhe Këpucëve, përfaqësues: Ljupço Radovski – kryetar.

104 Milka Ivanovska, “Organized labor in post-socialist Macedonia: the path to marginalization (1989-1998)” (2014) Central European University, Budapest, Hungary.

themeli, marrin një mendim të ngjashëm. SPASHK beson se:

duke fituar statusin e një personi juridik, motivimi duhet të jetë edhe më i madh për bashkimin e sindikatave të niveleve të larta një nivel më të larta.¹⁰⁵

që do të thotë se Sindikata nuk sheh rrezikun e shpërbërjes së organizimit sindikal.¹⁰⁶ Në këtë mënyrë, SPASHK u kushton një pjesë të konsiderueshme të intervistës filialeve të sindikatave dhe (mos)rregullimit të punës së tyre me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.¹⁰⁷ SPASHK beson se duhet të:

të bëhet një kornizë e caktuar, pra një kufi për sa i përket të drejtave, por edhe detyrimeve të filialeve që disponojnë, në mënyrë që sindikatat të mbrohen nga dëmet e mëdha,¹⁰⁸

dhe të dalin më të mbrojtura. Ngjashëm, SPA thekson se secila sindikatë duhet të ketë cilësinë e personit juridik, por shton se:

duhet të ketë një mundësi ligjore që sindikata të ketë apo jo filiale të saj te punëdhënës të ndryshëm, pa pasur statusin e një personi juridik, nëse kjo është në dobi të degës/veprimtarisë.¹⁰⁹

Është e qartë se SPASHK dhe SPA nuk kanë frikë të ‘ndajnë’ subjektivitetin juridik me më shumë sindikata,¹¹⁰ por ata besojnë se kjo nuk do të sigurojë mbrojtje të plotë ndaj abuzimeve në raport me të drejtat dhe përgjegjësitë. Në çdo rast, është e rëndësishme për këtë punim që të ketë marrëveshje midis këtyre sindikatave të degëve në lidhje me subjektivitetin juridik të të katër llojeve të sindikatave. Këtij dakordimi iu kanë bashkuar edhe konkludimet e SPPRRM dhe SOPTM, të cilat besojnë se të gjitha sindikatat duhet të jenë persona juridikë që në mënyrë të pavarur’... të veprojnë, disponojnë dhe vendosin për fondet e tyre...’¹¹¹ dhe se’... kjo është e domosdoshme për funksionimin e tyre...’.¹¹²

Megjithëse konkludimet e tilla krijojnë një pasqyrë fillestare të një konsensusi midis sindikatave të degëve në lidhje me subjektivitetin juridik, kjo është larg së vërtetës. Një pjesë e madhe e sindikatave, përfshi dy ato përfaqësuese në nivelin

105 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, përfaqësues: Jakim Nedelkov – kryetar.

106 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, përfaqësues: Jakim Nedelkov – kryetar.

107 Ligji për Shoqëritë Tregtare („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16, 61/16, 64/18 dhe 120/18).

108 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, përfaqësues: Jakim Nedelkov – kryetar.

109 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur Akademike, përfaqësues: Elena Xhukeska – u.d. kryetare.

110 Sipas legjislacionit aktual, SPASHK dhe SPAKM kanë statusin e personit juridik.

111 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Punëtorëve të Energjisë dhe Ekonomisë të Maqedonisë, përfaqësues: Robert Simonoski – kryetar.

112 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Operatorëve Postarë dhe Telekomunikimeve, përfaqësues: Boro Veligidenov – kryetar.

shtetëror, besojnë se përvetësimi i subjektivitetit juridik nuk do të sjellë ndonjë gjë të mirë, por vetëm do ta kthejë shtetin prapa. Sipas tyre, zgjidhja që siguron statusin juridik për të gjitha sindikatat “është parë tashmë dhe nuk ka dhënë asnjë fryt, vetëm i la punëtorët pa mbrojtje në momente shumë të ndjeshme”. Prandaj, ia vlen të shohim këtë anë të tregimit në mënyrë që të mund të nxjerrim përfundime objektive.

1.3. RREZIKU NGA MONOPOLIZIMI I ORGANIZIMIT SINDIKAL

SKRM dhe UPOZ janë një nga sindikatat e degëve që janë kundër idesë që secila sindikatë duhet të ketë statusin e një personi juridik. SKRM si arsye kryesore për këtë qëndrim shpreh faktin se:

aktualisht ekziston një problem [...] në institucionet e vogla që kanë disa punonjës dhe që dëshirojnë të jenë anëtarë të një apo një sindikate tjetër.¹¹³

Sipas tyre, punonjësit në një situatë të tillë që dëshirojnë të krijojnë organizatën e tyre sindikale, nuk kanë njerëz të mjaftueshëm për të plotësuar të gjithë organet e kërkuara në aplikacionin e regjistrimit dhe mbeten pa zyrë përfaqësimi.¹¹⁴ Kjo është një vërejtje legjitime, e cila mund të kapërcehet lehtësisht me rregullimin e mirë ligjor dhe kushtet e përshtatshme për sindikatat e niveleve të ndryshme. Në fakt, edhe me një zgjidhje të ndryshme ligjore sa i përket subjektivitetit juridik, sindikata në nivelin e punëdhënësit do të jetë në gjendje të regjistrohet, ashtu si deri më tani me ndryshimin që me regjistrimin, do të fitonte një status të veçantë juridik.

Edhe nëse e marrim parasysh këtë, UPOZ beson se “...zgjidhja aktuale e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës në këtë drejtim është e mirë dhe nuk duhet të ndryshohet...”.¹¹⁵ UPOZ beson se përvoja para ndryshimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, kur secila sindikatë kishte statusin e një personi të veçantë juridik, dhe

113 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Kulturës të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues: Goce Pavlovski – sekretar i përgjithshëm.

114 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Kulturës të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues: Goce Pavlovski – sekretar i përgjithshëm.

115 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e punëtorëve nga administrata, organet gjyqësore dhe shoqatat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues: Trpe Deanoski – sekretar i përgjithshëm.

kështu kishin numër tatimor dhe llogari të veçantë në bankat afariste, ishte shumë negative. Pasoja ishte keqpërdorimi i fondeve të anëtarësimit në sindikata nga disa sindikata dhe kishte abuzime dhe shpenzime joracionale.

Pas ndryshimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës në vitin 2012 [...] mbahet një kontabilitet për të gjitha sindikatat, ka një pasqyrë të shpenzimit të fondeve të anëtarëve dhe secila organizatë sindikale është e detyruar të paraqesë llogarinë e saj përfundimtare para anëtarëve, dhe e njëjta gjë bëhet nga Sindikata e nivelit më të lartë, së pari para Bordit Mbikëqyrës dhe pastaj para kryesisë.¹¹⁶

Shqetësimi i UPOZ është gjithashtu i justifikuar në lidhje me ndikimin e mundshëm që biznesmenët mund të kenë në zgjedhjen e një përfaqësuesi të sindikatës në nivelin e punëdhënësit, dhe kështu në sindikatat më të larta. Sidoqoftë, edhe në skenarin aktual, nuk përjashtohet mundësia e ndikimit në zgjedhjen e përfaqësuesve të sindikatës në nivelin më të ulët në atë më të lartë, por duket se UPOZ arriti të ruajë një ekuilibër të caktuar me vendimin e tyre.

Edhe me legjislacionin aktual, sindikatat kanë një lloj subjektiviteti të caktuar juridik. Në Sindikatën e UPOZ të gjitha sindikatat kanë llogarinë e tyre në bankat afariste, zgjedhin në mënyrë të pavarur përfaqësuesit e tyre, kanë vulën e tyre dhe mund të negociojnë me punëdhënësin në institucionet e tyre në lidhje me të gjitha çështjet.¹¹⁷

Së fundmi, për këtë çështje ka marrëveshje të paktën midis dy sindikatave më të mëdha në vend, sindikatave përfaqësuese të LSM dhe KSL. Të dy sindikatat mbështesin idenë e subjektivitetit juridik vetëm për sindikatat e niveleve më të larta. Sipas LSM, çdo zgjidhje tjetër mbart rrezikun e:

shpërbërjes së lëvizjes sindikale dhe përdorimin e sindikatave nga punëdhënësit për të realizuar interesat e tyre, e jo për rolin që sindikatat kanë.¹¹⁸

LSM beson se nëse organizatat sindikale në kompani kanë statusin e një personi juridik, çdo motivim për bashkim do të humbasë, sindikatat do të zbërthehen, do të ulet fuqia e tyre e negociimit, dhe poashtu mund të silllet në pikëpyetje edhe çështja e zhvillimit të dialogut social dhe marrëveshjeve kolektive në vend. Sipas tyre:

bashkimi është fuqia e sindikatave dhe kushdo që mbron një tezë ndryshe

116 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e punëtorëve nga administrata, organet gjyqësore dhe shoqatat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues: Trpe Deanoski – sekretar i përgjithshëm.

117 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e punëtorëve nga administrata, organet gjyqësore dhe shoqatat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, përfaqësues: Trpe Deanoski – sekretar i përgjithshëm.

118 E kuptueshme nga intervista me Lidhjen e Sindikatave të Maqedonisë, përfaqësues: Darko Dimovski – kryetar.

punon drejtpërdrejt në dëm të sindikatave dhe për t'i shpërbërë ato dhe në dëm të vetëm punëtorëve.¹¹⁹

Sindikata tjetër përfaqësuese në nivelin e përgjithshëm, KSL, thotë se nuk është e mundur "... të kontrollohet puna e të gjitha organizatave sindikale..."¹²⁰ dhe se një zgjidhje e ndryshme nga ajo aktuale do të ishte një goditje kundër stabilitetit të anëtarësimit dhe punës së sindikatave.¹²¹ Ata qartë tregojnë se nuk e shohin rëndësinë e subjektivitetit juridik, kur motivi dhe qëllimi i veprimit janë shumë më të rëndësishme. Prandaj, KSL e konsideron të rëndësishme të theksojë se:

sindikatat kanë statusin e personit juridik, e organizatat sindikale jo, kurse në pjesën e KSL-së veprojnë mbi mijëra organizata sindikale, pra imagjinoni si do të ishte veprimi i secilës sindikatë në veçanti?!¹²²

Sipas tyre, qëllimi i përpjekjeve për subjektivitetin juridik të secilës sindikatë është që të shpërnda një sindikatë kombëtare dhe të delegjitojë plotësisht veprimet sindikale të dialogut social dhe solidaritetit duke ushtruar një presion kaq serioz dhe duke imponuar ndryshimin e zgjidhjeve ligjore.

Pozicionimi aktual i bashkimit sindikal mbart në mënyrë të pashmangshme rreziqe serioze të monopolizimit të organizimit dhe mund të largojë punëtorët nga sindikatat e tyre mëmë. Deri më tani, zgjidhja ligjore në praktikë ka rezultuar me një paraqitje të zbehtë të sindikatave pa subjektivitetin juridik dhe probleme të shumta për sindikatat në një nivel më të lartë në drejtim të konsultimit dhe angazhimit të anëtarësisë.¹²³ Megjithatë, nuk mund të thuhet me siguri nëse subjektiviteti juridik është shkaku kryesor i kësaj situatë apo thjesht pasojë e problemeve të tjera. Sindikatat nuk vepruan në rolin e mbrojtësve të punëtorëve as gjatë hartimit të LMP-së, përfshi edhe dispozitat që rregullojnë lirinë e asociimit, dhe dështuan të informojnë siç duhet ata që përfaqësojnë se çfarë janë duke ndërmarrë për këtë çështje të caktuar. Është e vërtetë që ndryshimi në subjektivitetin juridik të sindikatave mund të sjellë probleme dhe dobësi të mundshme të reja në planin afatshkurtër, por duke pasur parasysh shkallën në të cilën është përkeqësuar situata e punëtorëve në vend, ajo zgjidhje duhet të konsiderohet për të bërë një krahasim adekuat.

119 E kuptueshme nga intervista me Lidhjen e Sindikatave të Maqedonisë, përfaqësues: Darko Dimovski – kryetar.

120 E kuptueshme nga intervista me Konfederatën e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, përfaqësues: Blagoja Ralpovski – kryetar.

121 E kuptueshme nga intervista me Konfederatën e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, përfaqësues: Blagoja Ralpovski – kryetar.


122 E kuptueshme nga intervista me Konfederatën e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, përfaqësues: Blagoja Ralpovski – kryetar.


123 Vildan Drpljanin, „Kush dhe si po (do të) i organizon sindikatat?“ (ResPublica, 2019) <<https://respublica.edu.mk/blog/2019-09-11-08-39-41>> qasja e fundit më 18.3.2020.



- PJESA E DYTË -


**SUBJEKTIVITET JURIDIK PËR TË
GJITHA SINDIKATAT**





Pozicionimi i organizimit sindikal përmes prizmit të Ligjit aktual të Marrëdhënieve të Punës dhe “parapalqimit” të statukuosë është shtjelluar në detaje në pjesën e parë të këtij punimi. Aktualisht, gjithçka që ka të bëjë me sindikatat, organizatat e punëdhënësve, marrëveshjet kolektive dhe grevat është futur në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.¹²⁴ Statusi i personit juridik është “i rezervuar” vetëm për sindikatat e niveleve më të larta.

Hartimi i Ligjit të ri për Marrëdhëniet e Punës solli me vete edhe çështjen e rregullimit më gjithëpërfshirës të kësaj problematike. Zgjidhja e propozuar ligjore që me shumë gjasë do të jetë përsëri pjesë e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, parasheh që të gjitha sindikatat, pa përjashtim, do të fitojnë statusin e një personi juridik në momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës. Kjo zgjidhje ligjore provokoi kundërshtim të ashpër nga sindikatat përfaqësuese dhe sindikatat e nivelit më të lartë. Për shembull, nëse punonjësit në një kompani vendosin të formojnë një sindikatë, ajo do të fitojë statusin e një personi juridik në momentin e regjistrimit në Regjistrin Qendror. Kjo është arsyeja pse kjo pjesë e punimit kërkimor, duke analizuar përgjigjet e të anketuarve nga intervistat e realizuara, do të sfidojë statukuonë. Përgjigja e pyetjes në lidhje me funksionin themelor të sindikatave do të na çojë në përgjigjen e dytë që kërkon ky punim, gjegjësisht do t’i përgjigjet dilemës nëse të gjitha sindikatat duhet të kenë subjektivitet juridik. Kjo pjesë do të tregojë se përvetësimi i statusit të një personi juridik për të gjitha sindikatat çon në forcimin thelbësor të organizimit sindikal, krahasuar me formën aktuale juridike të tyre.



¹²⁴ Kapitulli XVIII, XIX и XX nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 110/19).

2.1 (PA)MUNDËSIA PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT THEMELOR TË SINDIKATAVE

E drejta e garantuar me kushtetutë e punëtorëve për të formuar dhe bashkuar në sindikata për të ushtruar të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale është shkrirë në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës, dhe më pas në statutet e të gjitha sindikatave të themeluara. Kjo e drejtë theksohet më tej nga Organizata Ndërkombëtare e Punës e cila garanton që punëtorët dhe punëdhënësit, pa asnjë dallim dhe pa ndonjë aprovim paraprak, kanë të drejtë të themelojnë dhe të bashkohen në organizata sipas zgjedhjes së tyre.¹²⁵ ONP-ja thekson se përvetësimi i statusit juridik të organizatave të punëtorëve dhe punëdhënësve, federatave dhe konfederatave, nuk duhet t'i nënshtrohet kushteve që kufizojnë lirinë e asociimit.¹²⁶

Në përpjekje për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme për subjektivitetin juridik, ne sfiduar sindikatat që na përfaqësojnë të rishikojnë funksionin themelor për të cilin janë themeluar. Nga intervistat e kryera me 17 sindikata në Maqedoni, madje 13 sindikata shprehin qartë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve si funksionin themelor të sindikatave. Tri sindikatat e tjera dhanë përgjigje të ndryshme, por në thelb të ngjashme për sa më sipër, ndërsa SPSHFMS-ja beson se funksioni themelor i sindikatës është marrëveshja kolektive.¹²⁷ Në një situatë kur shumica e të anketuarve bien dakord që funksioni themelor i sindikatës është të mbrojtë të drejtat e punëtorëve, në mënyrë të pashmangshme lindi dilema se si sindikatat ‘më të ulta’, në mungesë të subjektivitetit juridik, do të mund të mbronin në mënyrë efektive anëtarët e tyre. SPASHK prezantuan skenarin në të cilin një sindikatë nuk gëzon statusin e një personi juridik dhe nuk mund të veprojë në mënyrë të pavarur në qarkullimin juridik. SPASHK konfirmon se në mungesë të subjektivitetit juridik, sindikatat ‘nuk do të mund (...) të kryenin misionin e tyre për të cilin janë themeluar’.¹²⁸ Nga SPA thonë se punëtorët kanë nevojë për mbrojtje sindikale si në nivelin e punëdhënësit ashtu edhe në atë të degës/veprimtarisë dhe shtojnë se është e rëndësishme të mundësohet që bashkimi sindikal të jetë funksional në të dy nivelet.¹²⁹

Mbrojtja funksionale sindikale, në praktikë, është e vështirë të arrihet kur sindikatat në nivelin e punëdhënësit nuk kanë subjektivitet juridik. Mbrojtja jofunksionale sindikale kur sindikatat përballen me një sfidë në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, do të prezantohet në tekstin më poshtë përmes një shembulli

125 Organizata Ndërkombëtare e Punës, Konventa Nr. 87 për Lirinë e Asociimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Organizim, e datës 1948 (neni 2).

126 Organizata Ndërkombëtare e Punës, Konventa Nr. 87 për Lirinë e Asociimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për Organizim, e datës 1948 (neni 7).

127 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur për Shëndetësi, Farmaci dhe Mbrojtje Sociale të Republikës së Maqedonisë.

128 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, përfaqësues: Jakim Nedelkov – kryetar.

129 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur Akademike, përfaqësues: Elena Xhukeska – u.d. kryetare.

konkret në kontekstin e ngjarjeve që ndodhën gjatë përgatitjes së këtij punimi.

Pasi u paraqitën disa raste të pacientëve të diagnostikuar me KOVID-19, më 10 mars 2020, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi disa masa dhe rekomandime për mbrojtjen dhe parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Masa e parë ndërpreu procesin arsimor dhe mësimdhënien në të gjitha kopshtet dhe shkollat fillore. Në të njëjtën kohë, Qeveria vendosi që për zbatimin e kësaj mase, një nga prindërit, fëmijët e të cilëve deri në moshën dhjetë vjeç vizitojnë kopshtet ose vijnë në mësimet në shkollë fillore, të lirohet nga detyrimi për të kryer detyrat e punës, respektivisht të lirohen nga puna. Menjëherë pas kësaj, u përcaktuan kategoritë e personave që duhet të lirohen nga puna dhe aktivitetet e punës, për shkak të kushteve të caktuara shëndetësore. Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli gjendje pandemie për shkak të sëmundjes KOVID-19. Më 14 mars, Qeveria u rekomandoi të gjithë punëdhënësve në vend, në varësi të llojit të punës dhe mundësive, të organizojnë punën përmes institutit “punë nga shtëpia”. Më 18 mars 2020, edhe Maqedonia shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në territorin e tërë vendit.

Në raportin e tij mujor për muajin mars, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut vëren se punëdhënësit, duke abuzuar me gjendjen e jashtëzakonshme të shpallur për ta luftuar koronavirusin, filluan anulimin masiv të kontratave të punës për grupe të tërë punëtorësh dhe, aty ku patën mundësi, kanë ndikuar mbi punëtorët për të ndërprerë me marrëveshje marrëdhënien e punës.¹³⁰ Agjencia e Punësimit ka regjistruar 43,086 persona që kanë mbetur të papunë pas fillimit të krizës në mars të vitit 2020.¹³¹ Në katër muajt e parë të krizës, nga maji deri në qershor të vitit 2020,¹³² Komiteti i Helsinkit regjistroi 182 denoncime për shkelje të të drejtave të punëtorëve që përfshinë afërsisht 2708 punëtorë. Nga këto, 90 denoncime nga të dhënat e regjistruara kishin të bënin me: largimin/pushimin e punëtorëve nga puna (43), ndërprerjen e imponuar me marrëveshje të marrëdhënies së punës (36), mos zgjatjen e kontratave të punës me afat të caktuar (10) dhe mos zgjatjen e kontratave të punës me afat të caktuar për punonjëset shtatzënë (4).¹³³ Inspektorati Shtetëror i Punës në periudhën nga 11 deri më 31 mars regjistroi gjithsej 1454 kërkesa nga qytetarë. Në 830 raste, punëtorët kishin kërkuar informacion në lidhje me masat e miratuara për mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit, kurse 624 kërkesat e tjera kishin të bënin me mosrespektimin e këtyre masave nga ana e punëdhënësve. Nga këto 624 kërkesa, 194 kishin të bënin me mosrespektimin e së drejtës për leje me pagesë

130 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut mars 2020“ (2020) <<https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshtaj-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedonija-mart-2020/>> qasja e fundit më 19.04.2020.

131 Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Pasqyrë e të dhënave për fluksin e hyrjes dhe daljes së personave të papunë“ (2021) <<https://av.gov.mk/pregled-na-podatoci-za-priliv-i-odliv-na-nevraboteni-lica.nspk>> qasja e fundit më 03.05.2021.

132 Të dhënat i referohen periudhës nga prezantimi i masës së parë të Qeverisë për mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit nga 10 mars deri më 31 maj.

133 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka publikuar të drejtat e punëtorëve gjatë koronavirusit përmes pesë infografikëve dy-javorë: <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot/>>, <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-3/>>, <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-3/>>, <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-4-2/>>, <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-5-2/>> dhe <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-6/>>, qasja e fundit më 15.6.2020.

të një prindi me një fëmijë deri në moshën dhjetë vjeç, 148 kërkesa për vendime për pushime/largime nga puna, ndërsa 282 kërkesat e tjera ishin për arsye të ndryshme në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve.¹³⁴ Në periudhën prej 6 deri më 9 prill, ISHP-ja regjistroi gjithsej 219 kërkesa nga qytetarë, nga të cilat 48 sosh kishin të bënin me mosrespektimin e masave të miratuara për mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit nga punëdhënësit, kurse 171 prej tyre ishin me karakter informues.¹³⁵

Duke pasur parasysh të gjitha këto, si dhe besimin e ulët në sindikata, nuk janë aspak befasese të dhënat për numrin e madh të shkeljeve të raportuara në organizatat e shoqërisë civile dhe mekanizmat e tjerë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, në këtë periudhë. Kjo situatë krize dhe rrethanat e jashtëzakonshme tregojnë vetëm se sa e vështirë është për punëtorët të kenë mbrojtje gjyqësore, veçanërisht përpara anulimeve masive të kontratave të punës, në rastet kur punëtorët nuk mund të mbështeten më në sindikatat që i konsiderojnë “më të afërta” me ta.

Nëse punëtorët do të kishin qasje dhe do të ishin në gjendje të merrnin mbrojtje primare ligjore me ndihmën e sindikatave të tyre amë, më të afërta me ta, të dhënat nga mbrojtësit e tjerë të të drejtave të punëtorëve do të tregonin një numër shumë më të ulët të shkeljeve të raportuara. Në mungesë të subjektivitetit juridik, sindikatat në nivelin e punëdhënësit nuk mund të mbrojnë indirekt dhe drejtpërdrejt të drejtat e punës të anëtarëve të tyre. Kjo do të thotë që sindikatat që nuk kanë statusin e një personi juridik nuk arrijnë të përmbushin funksionin e tyre themelor - mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në kushte “normale”, madje edhe më pak në kushte emergjente.

2.2 SUBJEKTIVITETI JURIDIK SI BAZË PËR FUNKSIONIMIN E SINDIKATAVE

Sipas legjislacionit të vendit tonë, standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve trajtohen si standarde për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.¹³⁶ Pikërisht në ligjërimin për mbrojtjen e grave punëtore si të drejta të njeriut, në pah del fuqia asimetrike midis sindikatave të nivelit më të lartë dhe sindikatave “më të ulta”. Për shkak të mungesës së subjektivitetit juridik të të gjitha sindikatave, punëtorët nuk mund të përdorin të gjithë mekanizmat dhe mënyrat e mundshme për të mbrojtur të drejtat e tyre, të cilët në këtë mënyrë e fusin vet-

134 Inspektorati Shtetëror i Punës, „Raport për koronavirusin – 15131 dhe faqja e internetit nga 11.03 deri 31.03.2020“ (2020) <<http://dit.gov.mk/?p=5522>> qasja e fundit më 23.04.2020.

135 Inspektorati Shtetëror i Punës, „Raport aplikimesh nga 06 deri 09.04.2020“ (2020) <<https://dit.gov.mk/?p=5671>> qasja e fundit më 04.05.2020.

136 George Politakis and International Labour Office (eds), *Protecting Labour Rights as Human Rights: Present and Future of International Supervision; Proceedings of the International Colloquium on the 80th Anniversary of the ILO Committee of Experts on the Application of Conventions and Recommendations*, Geneva, 24-25 November 2006 (International Labour Office 2007), 229.

veten në një rrezik edhe më të madh. Në kushte të tilla, sindikatat trajtohen si një problem, në vend se si një zgjidhje, dhe roli i tyre si një mekanizëm mbrojtës për punëtorët shpërfilllet plotësisht.

Një shembull i tillë është fabrika e Feni Industri në Kavadar, ku në periudhën pas privatizimit të saj deri në vitin 2017, kishin ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të punëtorëve, përfshi vonesat e pagave dhe uljen e pagave. Të dhënat nga një hulumtim tregojnë se në këtë fabrikë ishte themeluar një organizatë sindikale si pjesë e Sindikatës së industrisë, energjisë dhe minierave.¹³⁷ Në kushtet e shkeljes së të drejtave të punëtorëve dhe në mungesë të mbështetjes nga sindikata e degës, sindikalistët nga organizata sindikale që u përpoqën të ndërmerren veprime konkrete, u gjendën në një pozitë të prekshme dhe të pafuqishme përballë punëdhënësit. Një nga këta sindikalistë ndërmori veprim për të ndërprerë procesin e punës, pasi punëtorët kishin shprehur qartë vullnetin e tyre për të, në një anketë anonime të kryer paraprakisht. Duke vlerësuar se ai po përballej me një kërcënim, punëdhënësi filloi procedimin disiplinor kundër këtij punëtori, duke i bërë presion që të hiqte dorë nga çdo veprimtari sindikale.¹³⁸ Ky është vetëm një konfirmim tjetër i pretendimit se punonjësi dhe sindikata e nivelit më të ulët, të cilët nuk gjejnë mbështetje dhe mbrojtje nga sindikata e degës, janë në një pozitë shumë të pafavorshme.

Në një rast tjetër, një organizatë sindikale mbeti pa mbështetje nga SIEM në ushtrimin e së drejtës për grevë nga punëtorët e sindikatës në MZT Shkritore. Kryetari i organizatës sindikale në MZT Shkritore kërkoi mbështetje për organizimin e një greve nga sindikata amë SIEM. Vetëm pas një vonese pesë-mujore, sindikata e degës mbështeti 16 persona nga një departament i Shkrites MZT për të organizuar një grevë, për të ndaluar prodhimin dhe për të shprehur revoltën për shkak të pagave të papaguara për një periudhë prej një viti.¹³⁹ Greva rezultoi në pranimin e disa prej kërkesave të punëtorëve për nënshkrimin e një kontrate, ndryshimin e kontratave të punës, pagimin e pagave të tyre dhe regresin e pushimit vjetor. Dokumentet për realizimin e këtyre aktiviteteve janë përgatitur nga SIEM, por përmbanin dispozita të përcaktuara në mënyrë jo të saktë. Kryetari i organizatës sindikale kishte konsideruar se një marrëveshje e tillë ishte e dëmshme për punëtorët, nuk e kishte nënshkruar atë dhe për shkak të kësaj ai menjëherë e kishte humbur mbështetjen e sindikatës së degës. Në ndërkohë, ishte hapur proces falimentimi në Shkritoren MZT, dhe punëtorët nuk arritën të merrnin pretendimet e tyre monetare si kreditorë.¹⁴⁰

137 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017). Faqe 54-55.

138 Ibid.

139 Ibid. Faqe 67.

140 Ibid. Faqe 68.



Fotografia numër 2 - Protesta para Kuvendit nga ana e punëtorëve të Shkriores MZT.¹⁴¹

Duke pasur parasysh që në një degë, sindikata të ndryshme kanë kërkesa të ndryshme, është e nevojshme të merret parasysh pozicionimi organizativ i sindikatave të degëve. Për shembull, aktualisht Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës nuk ka një përfaqësim sektorial të pavarur, por multi-sektorial dhe rajonal, ku kryesisht janë të përfaqësuar mësuesit dhe punëtorët e tjerë të arsimit. Kështu, problemet dhe çështjet specifike, për shembull, për punëtorët e teatrit nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në sindikatën e degës.¹⁴² Për të forcuar sindikatat e niveleve më të ulëta dhe për të afirmuar pozicionin e tyre jashtë imazhit të gjerë të “degës”, është e nevojshme që të gjitha sindikatat të gëzojnë subjektivitetin juridik. Në kushte të tilla, organizatat e pavarura sindikale do të shkëputen nga sindikatat tradicionale të degëve me të cilat nuk ndajnë të njëjtën problematikë dhe ku zëri i tyre mbetet i shurdhër.

Hulumtimet empirike të deritanishme mbi shkallën e kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, me theks të veçantë sindikatat, kanë treguar se punëtorët janë të pakënaqur me punën e tyre. Madje 9,5 përqind e punëtorëve në Shtip të cilët morën pjesë në një fokus grup për shkallën e kënaqësisë me punën e sindikatave, u përgjigjën se nuk janë aspak të kënaqur me punën e tyre.¹⁴³ Punëtorët e tjerë nga Shtipi e lokalizojnë problemin në faktin se fabrikat në të cilat ata punojnë nuk kanë fare sindikatë. Mirëpo, edhe atëherë kur ishte themeluar një sindikatë, punëtorët thanë se përfaqësuesit e sindikatës janë më pranë punëdhënësve dhe këtij pretendimi iu bashkëngjiten edhe punëtorë të tjerë nga Ma-

141 Fotografia është marrë nga faqja në Facebook e Sindikatës së punëtorëve pranë Shkriores MZT.

142 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017). Faqe 58.

143 Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 41.

nastiri. Në të njëjtin hulumtim, 78.1 përqind e punëtorëve të anketuar nga Manastiri thanë se ishin plotësisht të pakënaqur me punën e sindikatave. Ata tregojnë një shembull kur një përfaqësues i sindikatës e kishte këshilluar punëdhënësin se si të shmangte detyrimin e tij për të paguar regresin e pushimit vjetor (K-15) në një restorant në Manastir.¹⁴⁴

Prandaj, shumica e sindikatave që intervistuaam e gjejnë zgjidhjen e këtij problemi pikërisht në mundësinë e dhënies së subjektivitetit juridik të sindikatave në nivelin e punëdhënësit. Katër nga sindikatat e anketuara u përgjigjën se në të njëjtën kohë me marrjen e statusit të një personi juridik, sindikatat do të përvetësojnë përgjegjësi më të madhe ndaj anëtarëve të tyre. Subjektiviteti juridik, sipas të anketuarve, do të sjellë transparencë më të madhe në punën e sindikatave në nivelin e punëdhënësit. Në një rast të tillë, sindikatat “do të mbajnë përgjegjësi ligjore në rast të mosrespektimit të obligimeve që dalin nga dispozitat ligjore”.¹⁴⁵ Për Sindikatën e Pavarur Akademike, „subjektiviteti juridik duhet të jetë baza për funksionimin e çdo sindikate”¹⁴⁶, i cili do të kontribuojë në rritjen e mundësive për realizimin e interesave të anëtarëve të sindikatës, dhe në të njëjtën kohë do të garantojë kontrollin e duhur të punës së personave përgjegjës.¹⁴⁷

Është interesante të theksohet se dy sindikatat më të mëdha përfaqësuese në vend, LSM-ja dhe KSL-ja, pavarësisht se bien dakord që funksioni themelor i sindikatave është mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, në mënyrë të njëjtë konsiderojnë se statusi i një personi juridik është, dhe duhet të jetë i destinuar vetëm për sindikatat e nivelit më të lartë.¹⁴⁸ Për më tepër, sipas LSM-së, me përvetësimin e subjektivitetit juridik do të humb motivimi i sindikatave “më të ulëta” për t’u bashkuar, ato do të shuhën dhe kjo mund të vë në pikëpyetje zhvillimin e dialogut social dhe marrëveshjen kolektive në vend.¹⁴⁹ Nëse motivi për t’u bashkuar do të humb vërtet nëse të gjitha sindikatat kanë subjektivitet juridik ose kjo është një frikë e pajustificuar e dy sindikatave më të mëdha që kërkojnë të mbajnë statukuonë e paprekur mbetet për t’u parë nga përgjigjet e të anketuarve të tjerë.

144 Ibid.

145 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur për Arsim dhe Shkencë, përfaqësues: Tomislav Gievski – kryetar.

146 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur Akademike, përfaqësues: Elena Xhukeska – u.d. kryetare.

147 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur Akademike, përfaqësues: Elena Xhukeska – u.d. kryetare.

148 E kuptueshme nga intervista me Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë, përfaqësues: Darko Dimovski – kryetar dhe nga intervista me Konfederatën e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, përfaqësues: Blagoja Ralovski – kryetar.

149 E kuptueshme nga intervista me Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë, përfaqësues: Darko Dimovski – kryetar.

2.3 MOTIVI PËR T'U BASHKUAR

Për mbrojtësit e statukuosë, të cilët janë më të preokupuar me debate politike dhe debate me njëra-tjetrën, përvetësimi i subjektivitetit juridik edhe për sindikatat në nivelin e punëdhënësit do të nënkuptojë një “goditje” për bashkimin e sindikatave.¹⁵⁰ Sidoqoftë, kjo pikëpamje e sindikatave më të mëdha mund të vështrohet edhe nga një kënd tjetër. Mund të argumentohet se ata kujdesen më shumë për korrektësinë politike të veprimeve dhe deklaratave të tyre sesa kujdesen për nevojat dhe problemet me të cilat përballet një punonjëse apo punonjëse maqedonase.¹⁵¹ Shikuar historikisht, debatet mbi sindikatat që nga fillimi i procesit të privatizimit, rrallë kanë vendosur në rend dite punëtorin në këto debate.¹⁵²

Duke mbrojtur veten, sindikatat më të larta kundërshtojnë dhënien e subjektivitetit juridik sindikatave në nivelin e punëdhënësit. Në përputhje me këtë pretendim, SOPT-ja tregon një shembull nga Sindikata e degës së punëtorëve të transportit dhe lidhjeve në LSM, ku ishin shkarkuar në mënyrë të padrejtë përfaqësuesit e sindikatës dhe u kishin bllokuar llogaritë e disa sindikatave, pa miratimin e anëtarësisë së tyre.¹⁵³ Sipas tyre, kur të gjitha sindikatat do të gëzonin statusin e një personi juridik, bashkimi në një nivel më të lartë do të marrë një dimension tjetër, sepse do të ishte “mbi një bazë vullnetare me synime të sinqerta për veprim të përbashkët dhe prosperitet”.¹⁵⁴ Duke supozuar që subjektiviteti i veçantë juridik nuk do ta dobësojë bashkimin dhe se në të njëjtën kohë decentralizimi do të rrisë pjesëmarrjen dhe besimin midis punonjësve, zgjidhja e re duket shumë më bindëse sesa statukuojta.

Sipas SPASH, me përvetësimin e subjektivitetit juridik:

përfaqësuesit e sindikatave [do të] mbajnë përgjegjësi më të madhe ndaj anëtarëve dhe në të njëjtën kohë do të shmanget lindja e e ndonjë sindikate kur të kenë nevojë qendrat politike të pushtetit.¹⁵⁵

SPPRRM konfirmon më tej nevojën për pavarësi dhe autonomi të të gjitha sindikatave. Ata thonë se subjektiviteti juridik i sindikatave “më të ulëta” do t’u garantojë “liri më të madhe veprimi dhe mendimi pa mundësinë e ndërhyrjes dhe shan-

150 E kuptueshme nga intervista me Lidhjen e Sindikatave të Maqedonisë, përfaqësues: Darko Dimovski – kryetar dhe nga intervista me Konfederatën e Sindikatave të Lira të Maqedonisë, përfaqësues: Blagoja Ralovski – kryetar.

151 Dimitar Apasiev, “Sindikalizmi në Republikën e Maqedonisë” (2013) Gazetë për çështje politike, sociale dhe kulturore “Novi Plamen” 18-19/2013, 155.

152 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017).

153 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Operatorëve Postarë dhe Telekomunikimeve, përfaqësues: Boro Veligdenov – kryetar.

154 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Operatorëve Postarë dhe Telekomunikimeve, përfaqësues: Boro Veligdenov – kryetar.

155 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur për Arsim dhe Shkencë, përfaqësues: Tomislav Gievski – kryetar.

tazhit të udhëheqjes për t'i bindur të jenë të dëgjueshëm''. Ata shtojnë se kjo do të shmangë kërcënimet ndaj të cilave aktualisht janë të ekspozuar përfaqësuesit e sindikatave, se ata do të zëvendësohen nga njerëz të tjerë që nuk janë "të afërt me anëtarësinë".¹⁵⁶

Sipas katërmbëdhjetë nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, subjektiviteti juridik nuk do të ndikojë negativisht në bashkimin e sindikatave në një nivel më të lartë. Për më tepër, disa prej tyre besojnë se kjo do të kontribuojë në forcimin e aleancës, solidaritetit dhe betejës së sindikatave për të realizuar interesat dhe qëllimet e përbashkëta. Një prej tyre është SPSHFMSM, sipas së cilës sindikatat do të bashkohen në një nivel më të lartë:

atje ku ata besojnë se do të kenë mbrojtje më të madhe të të drejtave të tyre. Me këtë, sindikatat e degëve do të kenë një motiv për angazhime më të mëdha në mënyrë që të tërheqin dhe mbajnë anëtarët në organizatat sindikale.¹⁵⁷

Frika e dy sindikatave më të mëdha duket e pajustificuar, pasi shumë sindikata thonë se përvetësimi i statusit të personit juridik do të forcojë nxitjen për t'u bashkuar në një nivel më të lartë. Në këtë rast, do të forcohet mbrojtja e të drejtave të punëtorëve në kurriz të statukuosë së paqëndrueshme. Dy sindikatat e tjera kombëtare, BSAPM dhe KOSM, ndajnë mendimin se të gjitha sindikatat duhet të kenë subjektivitetin e tyre juridik.

Unioni i Sindikatave Autonome dhe të Pavarura të Maqedonisë i konsideron sindikatat në nivelin e punëdhënësit si "qeliza themelore të çdo Bashkimi, Unioni dhe Konfederate".¹⁵⁸ Vetë emri i kësaj sindikate tregon përkushtimin e tyre për subjektivitetin juridik për të gjitha sindikatat, sepse në atë mënyrë "punëtorët do të jenë më të lirë për t'u bashkuar në mënyrë të pavarur, pa presion dhe ndikim".¹⁵⁹ Në këtë mënyrë, sindikata e themeluar në nivel punëdhënësi ose profesioni mund në mënyrë plotësisht të lirë të miratojë vendim për t'iu bashkuar ndonjë lidhje sindikatash, për të cilat kanë besim. BSAPM konfirmon qëndrimin tonë të mëparshëm se gjendja aktuale karakterizohet me një partizim të madh të sindikatave, dhe përmes çelësit partiak po zhvillohet edhe bashkimi sindikal dhe rekrutimi i anëtarëve të rinj përmes strukturave udhëheqëse. Sipas tyre, lufta për ekskluzivitetin e subjektivitetit juridik është në fakt një luftë vetëm për pushtet dhe për paratë e mbledhura nga anëtarësia e sindikatave. Përndryshe, nuk do të kishte asnjë pengesë për ndonjë sindikatë të vogël që të synonte të bashkohej në një aleancë, nëse ka besim

156 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur të Punëtorëve të Energjisë dhe Ekonomisë të Maqedonisë, përfaqësues: Robert Simonoski – kryetar.

157 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e Pavarur për Shëndetësi, Farmaci dhe Mbrojtje Sociale të Republikës së Maqedonisë.

158 Ky qëndrim është marrë nga recensa e punimit të bërë nga Biljana Çklamovska - bashkëpunëtore e jashtme e Unionit të Sindikatave Autonome dhe të Pavarura të Maqedonisë.

159 Ibid.

në të. Përveç kësaj, dhënia e subjektivitetit juridik për sindikatat më të ulëta do të inkurajojë edhe nënshkrimin e marrëveshjeve kolektive në nivelin e punëdhënësit, të cilat tani për tani janë të pakta. Jo rrallë ndodh që edhe punëtorët që i hartojnë marrëveshjet kolektive të përjetojnë mobing dhe presion të madh nga përfaqësuesit e sindikatave më të mëdha, duke pretenduar se vetëm ata janë nënshkrues të autorizuar të marrëveshjeve kolektive.

Praktikimi i një zgjidhje e tillë, sipas BSAPM, pritet të kontribuojë në formimin e sindikatave jopartiake që përfaqësojnë interesat e të gjithë punëtorëve në radhët e tyre, pavarësisht nga përkatësitë, pikëpamjet dhe/ose simpatitë e tyre politike. Ndryshimi i propozuar për subjektivitetin juridik ka kapacitetin për të hapur rrugën drejt kapërcimit të veçorisë kryesore të organizatës së sotme sindikale, luftën e ndërsjellë për epërsi dhe pushtet dhe kthimin në qëllimin kryesor për të cilin janë themeluar sindikatat, dmth mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Në mënyrë të ngjashme, presidenti i KOSM beson se nëse sindikata në një nivel më të ulët ka subjektivitetin e vet juridik, ajo do të kontribuojë shumë për një organizim më demokratik dhe më cilësor të punëtorëve. Në të njëjtën kohë, “në lëvizjen sindikale do të dalin në pah personazhe të rinj, të cilët (deri) tani për arsye subjektive dhe objektive nuk kanë mundur të dalin në pah”.¹⁶⁰ Sindikata në nivelin e punëdhënësit ose organizata sindikale me aftësinë e një personi juridik do të jetë në gjendje të marrë vendime në bindjen e saj, se cilës sindikatë të nivelit më të lartë do t’i bashkohet. KOSM është e bindur se ndryshimet në pjesën e subjektivitetit juridik brenda një kohe të shkurtër do të forcojnë cilësinë e dialogut social.¹⁶¹

Marrëdhëniet e punës vazhdimisht po pësojnë ndryshime në kontekstin bashkëkohor ekonomik dhe socio-politik, si një terren i gatshëm ku mund të veprojnë lidhjet/bashkimet e sindikatave. Korporatat gjigande multinacionale po zhvendosin qendrat e tyre të prodhimit në vende me fuqi punëtore të lirë, kushte fleksibël të marrëdhënies së punës dhe kushte të favorshme tregtare. Politikat që kanë kontribuar dhe mbajtur me sukses ekuilibrin e kësaj ndarje të punës rezultojnë në akumulimin e fitimeve të kompanive multinacionale në perëndim.¹⁶² Kjo strukturë e këtyre korporatave, të cilat vazhdimisht janë në kërkim të fuqisë punëtore të lirë, prodhon fuqi në të gjithë botën që shpesh përballet me të njëjtin punëdhënës multinacional.

Për më tepër, globalizimi ka shfaqur sfida të reja për sindikatat, të tilla si informalizimi dhe feminizimi i punës, migrimi, humbja e përfitimeve sociale, eksploatimi masiv dhe deindustrializimi.¹⁶³ Kriza e shkaktuar nga koronavirusi është vetëm fillimi i problemeve shëndetësore dhe mjedisore me të cilat do të përballen

160 Ky qëndrim është marrë nga recensa e punimit të bërë nga Marjan Risteski - kryetar i Konfederatës së Organizatave Sindikale të Maqedonisë.

161 Ibid.

162 Suzana Simonovska, Neda Petkovska, *Përmbledhje vjetore Annuaire, Knuza 72* (2019, Fakulteti Filozofik – Shkup), 533-554.

163 Kire Vasilev, Ana Guleva, *Sindikatat në Maqedoni* (2017). Faqe 33.

sindikatat, pasi ato probleme padyshim që ndikojnë në të drejtat e punëtorëve. Sidoqoftë, ky zhvillim si rezultat i globalizimit neoliberal ka hasur në rezistencë pikërisht nga sindikatat e nivelit më të ulët në vendet e zhvilluara ekonomikisht si Spanja, Italia, Franca, Gjermania, Britania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke ushtruar të drejtën e tyre për grevë, ata po hedhin poshtë kushtet e reja të punës dhe fleksibilitetin e punës të imponuara nga kapitali global.¹⁶⁴

Në këtë kuptim, nevojën për bashkim në nivel botëror e përmend edhe përfaqësuesi i Sindikatës së Punëtorëve të ERIDEN DOOEL - Manastir. Sipas kësaj sindikate në nivelin e punëdhënësit:

shumë nga kërkesat janë të përbashkëta për punëtorët që punojnë në të njëjtën degë/veprimtari, në të njëjtin vend, madje edhe në nivel global. Kjo është arsyeja pse është [i domosdoshëm] bashkimi gradual i sindikatave në nivelin e degës/veprimtarisë, sindikatave shtetërore, (kon) federatave rajonale të sindikatave, madje edhe në nivel botëror.¹⁶⁵

Të lehtësuar relativisht nga detyrimi për të ushtruar mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve drejtpërdrejt para punëdhënësve dhe institucioneve kompetente, sindikatat më të mëdha do të jenë në gjendje të përqendrohen drejt ballafaqimit të sfidave të reja karakteristike të neoliberalizmit. Detyrimi “i përjashtuar” do t’u përkasë kryesisht sindikatave në nivelin e punëdhënësit, të cilët, duke gëzuar plotësisht subjektivitetin e tyre ligjor, do të jenë në gjendje të realizojnë pa probleme, në mënyrë autonome dhe të pavarur qëllimin për të cilin janë themeluar.

164 Ibid. Faqe 34-35.

165 E kuptueshme nga intervista me Sindikatën e punëtorëve pranë ERIDEN DOOEL – Manastir, përfaqësues: Gorast Muratovski – anëtar i Këshillit ekzekutiv.



VËZHGIME PËRFUNDIMTARE

Sindikatat, si mekanizmi i parë i dëshiruar i mbrojtjes, nuk gëzojnë besim dhe nuk futin shpresë tek punëtorët, por është e padiskutueshme që një organizatë sindikale funksionale është e vetmja garanci afatgjatë për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Punëtorët gra dhe burra që nuk janë të kënaqur me punën e sindikatave sepse i konsiderojnë ato joefikase, të korruptuara dhe/ose kolaboracioniste me bosët dhe partitë, presin dhe shpresojnë të shohin ndryshime dhe lëvizje në skenën sindikale. Një lëvizje të konsiderueshme në këtë drejtim mund të ofrojë zgjidhja që parashikon subjektivitetin juridik për secilën sindikatë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një sindikatë në nivelin e punëdhënësit, profesionit, degës ose sindikatës së përgjithshme. Të dhënat e mbledhura nga intervistat me përfaqësuesit e 17 sindikatave nga të gjitha nivelet

ofruan një argument shumë të fortë për një ndryshim të tillë. Megjithëse rrezikut për shpërbërjen e organizatës sindikale, mundësitë për ndikim në zgjedhjen e përfaqësuesve të sindikatës, paqëndrueshmëria e anëtarësismit dhe puna e sindikatave u renditën si problemet që do të ndodhnin gjatë një ndryshimi të tillë, u shpërfill fakti që këto fenomene janë të pranishme edhe në statukuonë. Motivi i bashkimit në një nivel më të lartë është zakonisht formal, bosët krijojnë lehtësisht mundësi për emërimin e përfaqësuesve të sindikatës dhe qëndrueshmëria e anëtarësismit dhe puna e sindikatave do të jetë vazhdimisht në pikëpyetje. Në një situatë të tillë, nevojitet ndërhyrje në vetë rrënjën e problemit, në subjektivitetin juridik të sindikatave. Në fakt, shumica dërrmuese e numrit të përgjithshëm të të anketuarve, madje katërmbëdhjetë sindikata, deklaruan qartë se subjekti-

viteti juridik nuk do të ndikojë negativisht në bashkimin e sindikatave në një nivel më të lartë, gjë që forcon më tej argumentin për një qasje të re.

Zgjidhja e tanishme siguron statusin ligjor vetëm për sindikatat e niveleve më të larta, sindikatat e niveleve të degëve dhe sindikatat e përgjithshme, që do të thotë se vetëm ata mund të kenë llogarinë e tyre të transaksionit, të kenë një vulë dhe të paraqesin padi në një gjykatë kompetente. Në praktikë, kjo shpesh reflektohet në monopolizimin e organizatës sindikale, largimin e punëtorëve nga sindikatat në nivelin e punëdhënësit dhe aneksimin e sindikatave të nivelit më të ulët nga format më të larta të sindikatave. Ndryshimi në subjektivitetin juridik fillimisht mund të rezultojë në disa pasiguri, derisa të kalojë një periudhë adaptimi. Sidoqoftë, në planin afatgjatë, një ndryshim i tillë me siguri do të forcojë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe do të krijojë sindikata më afër anëtarëve të saj, të cilët kujdesen për nevojat dhe problemet me të cilat përballet një punëtor maqedonas. Statusi i gjerë juridik do të vazhdojë t'u mundësojë sindikatave të konsolidohen dhe të formojnë aleanca më të mëdha, jo sepse e kanë domosdo, por sepse duan dhe sepse e kuptojnë nevojën për një bashkim të madh dhe të fortë të organizimit sindikal. Në fakt, ky është pozicioni i katërbëdhjetë nga gjithsej shtatëmbëdhjetë sindikatat e konsultuara, të cilat konsiderojnë se subjektiviteti juridik nuk do të ndikojë negativisht në bashkimin sindikal. Për më tepër, statusi i një personi juridik për të

gjitha sindikatat do të nënkuptojë një rritje të mundësive përmes të cilave mund të mbrohen punëtorët, anëtarë të një sindikate të caktuar, si dhe një rritje të prezencës së sindikatave të nivelit më të ulët.

Karakteri kryesisht teorik i këtij diskutimi deri në implementimin e zgjidhjes që çdo sindikatë duhet të ketë statusin e një personi juridik dhe subjektivitetin e tij ligjor mund të sjellë në mënyrë të pashmangshme sfida të reja për sindikatat. Prandaj, një rishikim i plotë dhe konsultim gjithëpërfshirës është absolutisht i nevojshëm në përgatitjen e akteve nënligjore në lidhje me ligjin/ligjet nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Kjo do të zgjidhë një numër çështjesh, të tilla si mënyra sesi do të regjistrohen dhe evidentohen sindikatat, duke siguruar një zbatim të unifikuar dhe të qartë. Ndërkohë, sindikatat, të udhëhequra nga ato të përgjithshme, do të duhet të punojnë thelbësisht në strukturat e tyre të brendshme dhe të përgatisin një plan të përbashkët avokimi që do të sigurojë që punëtorët të jenë të bashkuar/unanimë gjatë negociatave të tyre me institucionet dhe punëdhënësit. Në këtë mënyrë, mund të krijohen kushte për forcimin e sindikatave maqedonase, dhe kjo vetëm nëse ndryshimi i propozuar shoqërohet me një transformim më të gjerë shoqëror të statukuosë në të cilën ndodhet aktualisht organizimi sindikal.

Përvetësimi i statusit të një personi juridik me momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës, për sindikatat do të jetë hapi i parë

në rrugën e gjatë drejt forcimit të aleancës, solidaritetit dhe betejës për të realizuar interesat dhe qëllimet e përbashkëta. Debati mbi demokratizimin e lëvizjeve punëtore dhe luftën sindikale do të ishte i paplotë nëse çështja e subjektivitetit ligjor nuk ndiqet nga elementët e tjerë të rëndësishëm të lëvizjes sindikale. Në këtë kuptim, është e nevojshme të shqyrtohet më tej çështja e bashkëpunimit ekumenik dhe kumulativ, dhe kështu një grup cilësor zgjidhjesh dhe strategjisht për pjesëmarrje dhe presion në të gjitha drejtimet. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet dialogut social, prezantimit para punëdhënësve/bosëve,

qëndrimin ndaj shtetit i cili në aspektin e sindikatave dhe punëdhënësve shfaqet si një "gjoja instanvë e parvarur",¹⁶⁶ duke informuar punëtorët për fatin e punëtorëve të tjerë në vend dhe ndikimi i tyre, dhe zhvillimi i një kulture solidariteti.

Veprimet dhe lëvizjet e sindikatave duken të pashmangshme, mbetet për t'u parë nëse ndryshimi në rregullimin e subjektivitetit juridik do të paraqesë një shtytje mjaft të fortë në shpinë, që gjërat të fillojnë të lëvizin drejt mbrojtjes reale të të drejtave të punëtorëve.

166 Kjo pikëpamje është marrë nga recensa e punimit të përgatitur nga studiuesi Mariglen Demiri.

LISTA E REKOMANDIMEVE TË SYNUARA

1. Fillimin e procedurës parlamentare për Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.
 - I. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të dërgojë versionin përfundimtar të zgjidhjeve ligjore në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sa më shpejt të jetë e mundur;
 - II. Versioni përfundimtar i zgjidhjeve ligjore, mbi të cilat grupi i punës në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ka punuar që nga vera e vitit 2018, para dhe pas amendamenteve në Kuvend, t'i komunikohet në mënyrë përkatëse ekspertëve dhe publikut të gjerë;
 - III. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut të fillojë procedurën parlamentare për miratimin Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.
2. Miratimi i një zgjidhje ligjore që parashikon statusin e personit juridik dhe subjektivitetin e veçantë juridik për secilën sindikatë.
 - I. Kuvendi të finalizojë procedurën parlamentare dhe të miratojë ligjin;
 - II. Kuvendi të miratojë zgjidhjen ligjore si një dispozitë e Ligjin për Marrëdhëniet e Punës siç propozohet aktualisht në versionin përfundimtar të projektligjit: përvetësimi i statusit juridik në momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës.
3. Ekzaminim dhe konsultim të gjerë me rastin e definimit të akteve nënligjore që do të përcaktojnë sistemin e ri të pozicionimit të sindikatave.
 - I. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të sigurojë pjesëmarrjen e gjerë të palëve të interesuara në formulimin e zgjidhjeve të akteve nënligjore që do të përcaktojnë funksionimin e sindikatave.
4. Përgatitja e një plani për përfaqësimin e përbashkët të sindikatave me të cilin punëtorët do të sigurojnë unanimitetin e tyre në negociatat me institucionet dhe punëdhënësit.
 - I. Sindikatat e përgjithshme të fillojnë dhe të udhëheqin procesin e përgatitjes së këtij plani;

- II. Bartësit e këtij procesi të përfshijnë të gjitha sindikatat që mund të kontaktohen, pavarësisht cilin nga katër nivelet përfaqësojnë (sindikatat e nivelit të punëdhënësve, profesionit, degëve dhe sindikatat e përgjithshme);
- III. Sindikatat duhet të mundësojnë që konsultimet të jenë sa më gjithëpërfshirëse, që do të thotë përfshirjen e të gjitha organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të punës, duke marrë parasysh edhe konkludimet e tyre.

LITERATURA E KONSULTUAR

- biljana jovanoviç, branimir jovanoviç, viktor mitevski, viktor stojkoski „Pabarazia në kohën e koronavirusit - Efektet e pandemisë Kovid-19 në ekonominë maqedonase: shkurtimisht për politikat“ (2021) <<https://zmai.mk/wp-content/uploads/2021/01/Efektite-od-Kovid-vrz-MK-ekonomija-MK.pdf>>.
- VILDAN DRPLJANIN, „Kush se si (do të) po organizon sindikatat?“ (ResPublica, 2019) <<https://respublica.edu.mk/blog/2019-09-11-08-39-41>>.
- VILDAN DRPLJANIN, „Punëtorë të padukshëm“ (ResPublica, 2020) <<https://respublica.edu.mk/mk/blog/2020-10-26-11-16-26>>.
- VILDAN DRPLJANIN, „Puna dhe djersa janë tonat, paratë dhe kapitali u përkasin 900 njerëzve në vend“ (ResPublica, 2020) <<https://respublica.edu.mk/mk/blog/900>>.
- SHOQATA PËR HULUMTIM DHE ANALIZA ZMAI, „Efektet e KOVID-19 në prodhimin industrial të industrisë së tekstilit dhe lëkurës“ (29 mars 2021) <<https://zmai.mk/ефектите-од-covid-19-врз-индустрискогo-произ/>>.
- SHOQATA PËR HULUMTIM DHE ANALIZA ZMAI, „Rritje e numrit të papunëve gjatë pandemisë në industrinë e tekstilit“ (25 shkurt 2021) <<https://zmai.mk/зголемен-бројот-на-невработени-лица-в/>>.
- IVAN KATARXHIEV, IVAN MAZOV DHE SLAVKO MANDIÇESKI Artikuj të zgjedhur mbi lëvizjen punëtore dhe socialiste në Maqedoni (1962).
- INSTITUTI PËR KËRKIME DHE POLITIKA EKONOMIKE Finance Think, „Efektet ekonomike nga kriza e koronavirusit“ (prill 2020) <https://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2020/10/QLife_No.3.pdf>.
- INSTITUTI PËR KËRKIME DHE POLITIKA EKONOMIKE Finance Think, „Sa Kovid-19 do të rrisë varfërinë në Maqedoninë e Veriut?“ (nëntor 2020) <<https://www.financethink.mk/wp-content/uploads/2020/11/PB43-2.pdf>>.
- Kire Vasilev, Mariglen Demiri, Natasha Neshevaska, Nikolla Shteriov „Analizë e nivelit të kënaqësisë nga mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut“ (2019) Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.
- kire vasilev, ana guleva, Sindikatat në Maqedoni, (Lëvizja majtiste „Solidarnost“, 2017).
- kosta solev racin, Vepra poetike (Makedonska kniga 1936).

- orde ivanovski, mile todorovski, lazar lazarov, borislav petkovski, jovan janev dhe marjan dimitrievski, Historiku i lëvizjes sindikale në Maqedoni (Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë 2008).
- orde ivanovski, Lëvizja sindikale e punëtorëve në Maqedoni deri në vitin 1918 (Komunist, 1985).
- suzana simonovska, neda petkovska Përmbledhje vjetore Annuaire, Libri 72 (2019, Fakulteti Filozofik - Shkup).
- todor kalamatiev, aleksandar ristovski „Marrëdhëniet e punës në kushtet e krizës shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuar nga Kovid-19“ (janar 2021) <<https://bit.ly/3h1LyGW>>.
- tome georgievski, Sindikatat bashkëkohore - Bazat dhe veprimet juridike-politike (2000).
- Andrea Komlosy, Work: The Last 1,000 Years (Verso 2018).
- Beverly J. Silver, Forces of Labor: Workers' Movements and Globalization since 1870 (Cambridge University Press 2003).
- Child J, Loveridge R and Warner M, "Towards an Organizational Study of Trade Unions" (1973) 7 Sociology 71.
- Cornelia Staritz, Mike Morris, Leonhard Plank, "Clothing Global Value Chains and Sub-Saharan Africa: Global Exports, Regional Dynamics and Industrial Development Outcomes", vol 2016/16 (2016) International Trade Working Paper 2016/16.
- Dimitar Apasiev, "Sindikalizmi në Republikën e Maqedonisë" Gazetë për çështje politike, sociale dhe kulturore "Novi Plamen" 18-19/2013 (2013).
- Doellgast VL, Lillie N and Pulignano V, Reconstructing Solidarity: Labour Unions, Precarious Work, and the Politics of Institutional Change in Europe (First edition, Oxford University Press 2018).
- Eric J. Hobsbawm, Age of Extremes: The Short Twentieth Century 1914-1991 (first published 1994, Abacus Books 1995).
- Eric J. Hobsbawm, Labouring men: Studies in the History of Labour (first published 1964, Anchor Books 1967).
- Folker Frobel, Jürgen Heinrichs and Otoo Kreye, "The New International Division of Labour" (1978) 17 Social Science Information 123.
- Fred Singleton, A Short History of the Yugoslav Peoples (Cambridge University Press 1985).
- Friedrich Ebert Foundation, "Annual review of labour relations and social dialogue" (2018) <>.
- George Politakis and International Labour Office (eds), Protecting Labour Rights as Human Rights: Present and Future of International Supervision; Proceedings of the International Colloquium on the 80th Anniversary of the ILO Committee of

Experts on the Application of Conventions and Recommendations, Geneva, 24-25 November 2006 (International Labour Office 2007).

- Gregor Gall, The International Handbook of Labour Unions: Responses to Neo-Liberalism (Elgar 2011).
- ILOSTAT, "Industrial relations", Summary Reports, <<https://bit.ly/2SYvgD3>>.
- Mies Maria, Patriarchy and Accumulation on a World Scale: Women in the International Division of Labour (Zed Books 2001).
- Milka Ivanovska, "Organized labor in post-socialist Macedonia: the path to marginalization (1989-1998)" (2014) Central European University, Budapest, Hungary.
- Michael Yates, Why Unions Matter (2nd ed, Monthly Review Press 2009).
- Norman Geras, The Legacy of Rosa Luxemburg (Verso Books, 2015).
- Robert G. Hall, "Tyranny, Work and Politics: The 1818 Strike Wave in the English Cotton District" (1989) 34 International Review of Social History.
- Sabrina P. Ramet, The Three Yugoslavias: State-Building and Legitimation, 1918-2005 (Woodrow Wilson Center Press; Indiana University Press 2006).
- Simpson RC, "The Significance of the Legal Status of Trade Unions in Britain and Australia" (1976) 18 Journal of Industrial Relations.
- Valerija Botrić, "Structural unemployment and its determinants in Southeast Europe", Ekonomska misao i praksa (1), 2011.

DOKUMENTE

- AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, „Pasqyrë e regjistrimit të personave të papunë 2020“, 2020,
- <https://av.gov.mk/content/Statisticki%20podatoci/Maj%202020/Nevraboteni_maj.pdf>.
- AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, „Pasqyrë e personave të papunë deri më 31.05.2020 dhe të dhëna për hyrjen dhe daljen e personave të papunë në periudhën nga 01.05.2020 deri më 31.05.2020“, 2020,
- <https://av.gov.mk/content/Statisticki%20podatoci/Maj%202020/01prilivodliv_052020.pdf>.
- AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, „Pasqyrë të dhënash për hyrjen dhe daljen e personave të papunë “ (2021) <<https://av.gov.mk/pregled-na-poda->

toci-za-priliv-i-odliv-na-nevraboteni-lica.nspj>.

- INSPEKTORATI SHITETËROR I PUNËS, „Raport aplikimesh nga 06 deri më 09.04.2020“ (2020) <<http://dit.gov.mk/?p=5671>>.
- INSPEKTORATI SHITETËROR I PUNËS, „Raport për koronavirusin - 15131 dhe faqja e internetit nga 11.03 deri 31.03.2020“ (2020) < <http://dit.gov.mk/?p=5522>>.
- ENTI SHITETËROR I STATISTIKËS, „Paga mesatare mujore e paguar neto për punonjës, shkurt 2021“ (2021) <<https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstanie.aspx?rbtxt=40>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - mars 2020“ (2020) <<https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshtaj-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedonija-mart-2020/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - dhjetor 2020“ (2020) <<https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshta%dl%98-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedoni%dl%98a-dekemvri-2020/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - prill-maj 2021“ (2021) < <https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshtaj-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedonija-april-maj-2021/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, „Raport i veçantë për situatën e të drejtave të njeriut në kohën e Kovid-19“ (2020) <<https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshta%dl%98-za-sosto%dl%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.1“ <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.2“ <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-3/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.3“ <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-3>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.4“ <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-br-3>>.

[sot-br-4-2](#)>.


- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.5“
- <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronaviru-sot-br-5-2/>>.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Infografik „Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit nr.6“
- <<https://mhc.org.mk/reports/rabotnichkite-prava-vo-vreme-na-koronaviru-sot-br-6/>>.

LEGJISLACIONI

- Organizata Ndërkombëtare e Punës. Konventa Nr. 87 për lirinë e asociimit dhe mbrojtjen e të drejtës për organizim, 1948.
- Kuvendi i Republikës Popullore të Maqedonisë. Ligji për Reformën Agrare dhe Kolonizimin, („Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Maqedonisë“ nr. 3/1946) miratuar më 9.2.1946, në fuqi më 17.3.1946.
- Kuvendi i Republikës Popullore të Maqedonisë. Ligji për Reformën Agrare dhe Kolonizimin („Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Maqedonisë“ nr. 3/1946) miratuar më 9.2.1946, në fuqi nga 17.3.1946.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 52/1991), miratuar më 17.11.1991.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/93 e datës 30.12.1993), miratuar më 27.12.1993, në fuqi nga 6.1.1994.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 110/19), miratuar më 22.7.2005, në fuqi nga 5.8.2005.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Ligji për Shoqëritë Tregtare („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10, 24/11, 166/12, 70/13, 119/13, 120/13, 187/13, 38/14, 41/14, 138/14, 88/15, 192/15, 6/16, 30/16, 61/16, 64/18 dhe 120/18), miratuar më 30.4.2004, në fuqi nga 8.5.2004.
- Kuvendi i Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, Ligji për Nacionalizimin („Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë nr. 98/II), miratuar më 5.12.1946, në fuqi nga 6.12.1946.

ALEANCË, SOLIDARITET
DHE BETEJË

SFIDIMI I STATUKUOSË SË SINDIKALIZMIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS



**KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT**